



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.06.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Vendimi nr. 307, datë 23.05.2018 “Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të listës së kandidatëve të kualifikuar për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Dashamir Shehi, Nadire Meçorapaj, Edmond Haxhinasto, Ismet Beqiraj, Dhurata Çupi dhe deputetë të tjerë të Partisë Demokratike.

Mungojnë:

Blerina Gjylameti, Agron Shehaj, Përparim Spahiu dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Kozeta Vuksanlekaj Frangaj

Gjergji Kosta

Nertil Kanina

Hektor Muçaj

Ela Ishka

Andi Dedndreaj

Petro Thanasko

Julian Dhima

Dritan Naksi

Altin Kulla
Blerim Braja

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe të Financave të Kuvendit.

Siç jeni njoftuar, në rendin e ditës së punës së këtij komisioni vijon seanca dëgjimore me kandidatët e propozuar për të qenë anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik. Dje kemi dëgjuar 12 kandidatë dhe sot do të dëgjojmë edhe 11 të tjerë. Njëri nga kandidatët ka njoftuar komisionin se nuk është i gatshëm të paraqitet në një seancë dëgjimore. Do të fillojmë me radhë.

Fjalën e ka zonja Tabaku, por jo si kandidate.

Jorida Tabaku – Faleminderit, kryetar!

Ne dje ngritëm shqetësimin për çështjet e korrupsionit në prokurimet publike. Komisioni i Prokurimit Publik ka muaj që nuk funksionon. Ky mund të ishte një avantazh i këtij komisioni, duke pasur parasysh cilësinë e kandidatëve që u paraqitën dy muaj më parë. Ishte një vendim i mirë i përbashkët, ndër të paktët vendime të përbashkëta në këtë komision, por, me gjithë kontributin dhe përpjekjet që opozita dha edhe në atë dëgjese, edhe në instanca të tjera, fatkeqësisht, kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik, megjithëse ky komision e rrëzoi dhe i sugjeroi Kuvendit të mos e propozonte për atë pozicion, zonja Shurdha u propozua. Çdo gjë tjetër që ndodh në këtë komision, dëgjese tjetër me anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik, për mua nuk ka vlerë, megjithëse ne do të kishim shumë dëshirë të jepnim kontributin tonë, duke pasur parasysh që prokurimi publik është një nga turpet më të mëdha të kësaj qeverie dhe një nga fushat ku korrupsioni gjigant masiv është duke prekur të gjitha institucionet e vendit, si në nivel lokal, edhe në nivel qendror.

Pse insiston dhe flet Partia Demokratike për korrupsionin, duke pasur parasysh se në 5 vjet qeverisje nuk ka ndodhur asgjë dhe nuk është marrë asnjë masë, si nga sugjerimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, edhe nga të gjitha denoncimet dhe dosjet që ne kemi çuar në prokurori? U kujtoj anëtarëve të komisionit se Partia Demokratike ka çuar mbi 12 dosje në prokurori, duke filluar me denoncime për afera korruptive, kontrata koncesionare korruptive të Ministrisë së Shëndetësisë dhe duke vazhduar me denoncime për çështjet që ka denoncuar Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Dje u përmendën disa shifra, që çdo qeveri do ta kishin vendosur në lëvizje, do të kishin qenë një kampanë alarmi. Çdo javë një zyrtar denoncohet në prokurori nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. 3,2 miliardë euro dëm ekonomik është nxjerrë po nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. 1 në 3 tenderë jepet pa garë. Kjo paraqitet në buletinët zyrtarë të publikuar nga

qeveria e Shqipërisë dhe jo nga shifrat e opozitës, të cilat janë përkeqësuar në 5 vjetët e fundit.

Nëse prokurimi publik njihej në çdo progresraport si një nga arritjet e qeverisë së mëparshme para vitit 2013 për rritjen e transparencës, sot ne jemi hapa pas në këto çështjet. Siç e thoshte edhe strategjia e zgjerimit, që është përmendur herë pas here, njëkohësisht edhe në deklaratën dhe propozimin që ka bërë zoti Flankeshtajn për Parlamentin Europian, prokurimi publik është thembra e Akilit për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për një arsye të thjeshtë, sepse po ndodh ajo që ndodhi në Shqipëri. Interesat private kriminale të ndërthurura me interesat publike të shtetit janë duke kapur çdo tender publik. Janë 11 persona që marrin çdo tender publik në Republikën e Shqipërisë. Janë 4 persona që marrin çdo koncesion në Republikën e Shqipërisë. Janë po të njëjtët persona, të cilët, si në pushtetin qendror, edhe në pushtetin lokal, vazhdojnë t'i shpërndajnë tenderë njëri-tjetrit, ndërkohë që parlamenti dhe qeveria e Shqipërisë nuk marrin asnjë masë.

Korrupsioni është një nga arsyet pse janë në rrezik negociatat javën e fundit të qershorit. Lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit duhet të ishte prioritare për këtë qeveri, por asgjë nuk ndodh. Lufta ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit sot duhet të kishte raste dhe shembuj konkretë, që Shqipëria të avanconte dhe të kishte një lajm pozitiv për hapjen e negociatave, por, fatkeqësisht, kjo nuk ndodh. Sado ta përsërisim ne, sado të ngremë shqetësimin, shkon në vesh të shurdhër nga ana e qeverisë, sepse ky është vullneti politik i qeverisë. Kjo nuk është diçka sporadike që ndodh sepse qeveria dhe institucionet nuk e marrin vesh, por është një sistem i ngritur për të dhënë çdo tender dhe çdo koncesion tek të njëjtët persona.

Kemi denoncuar muajt e fundit dhe të paktën që nga shtatori koncesionin e tre inceneratorëve prej 178 milionë eurosh. Deri më sot janë paguar 18 milionë euro pa filluar puna. Asnjë tullë nuk është hedhur në inceneratorin e Fierit, asnjë tullë në inceneratorin e Tiranës dhe pagesat vazhdojnë.

Kemi denoncuar pafund problemet që ka pasur projektligji që erdhi këtu për menaxhimin e kontratës së aeroportit të Vlorës. Sot jemi në qershor, kanë kaluar 6 muaj dhe nuk kemi asnjë të re nga kjo përveçse një kompani fantazmë të ngritur për *Air Albania*.

Kemi denoncuar në këtë komision pafund shifrat e publikuara nga qeveria, jo nga opozita, për lejet e ndërtimit të dhëna nga Bashkia Tiranë në mënyrë specifike, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, faktin që sistemi bankar nuk po krediton biznesin dhe asgjë nuk po ndodh.

Sigurisht, në një vend normal prokuroria do të ishte vënë në lëvizje, por jo prokuroria e përkohshme që kemi ne këtu. Në një vend normal Gjykata Kushtetuese do të ishte

institucioni ku të gjitha palët do t'i drejtoheshin, siç i është drejtuar në të shkuarën Partia Demokratike për një sërë ligjesh. Sot nuk kemi ku të drejtohem. Sot shteti ka rënë, nuk ka gjykata, nuk kemi prokurori. Sot kemi vetëm një qeveri që merr vendime për të gjithë, që përfaqëson ekzekutivin, legjislativin dhe çdo degë tjetër vendimmarrëse në këtë vend.

Unë do të kisha dashur shumë që reforma në drejtësi, që miratuam me 140 vota, për të cilën Partia Demokratike luftoi shumë të ishte konsensuale dhe të krijonte një balancim të pushteteve, sot të kishte filluar të zbatohej. Fatkeqësisht, ndodhi ajo që ne kishim parashikuar. Reforma në drejtësi ishte thjesht flluska e radhës, siç kanë qenë të gjitha reformat e kësaj qeverie në fund të ditës: reformë territoriale që nis për të ulur shpenzimet dhe përfundon me 60 milionë euro shtesë shpenzime; reformë në sistemin energjetik, që nis për të reformuar sektorin, por përfundon në rritjen e çmimit për 75% të familjeve shqiptare; reformë në arsim, që sot ka varfëruar xhepat e shqiptarëve, ka shkatërruar universitetet publike dhe në fund të ditës është fajtorja kryesore se pse të rinjtë po largohen nga ky vend. Asgjë në këtë vend nuk ka funksionuar në këta 5 vjetët e fundit.

Për t'i vënë kapakun, taksën e pronës ne e diskutuam edhe me kërkesën e opozitës dhe bashkëpunimin tuaj, bëmë dëgjese me ministrin e Financave. Na u tha se nuk do të ketë asnjë efekt te bizneset, se është në rregull çdo gjë me *data base-t* dhe do të fillojë funksionimi. Bizneset në qytetin e Tiranës kanë marrë fatura të rritura të taksës së pronës të rritur 2 deri në 4 herë, që janë duke i detyruar të mbyllin dyert e biznesit, sepse krahas kësaj, më 1 prill hyri në fuqi edhe TVSH-ja për bizneset me këtë xhiro.

Ka shumë arsye për të cilat ne kemi insistuar në këtë komision, duke filluar me çështjet e biznesit dhe duke vazhduar me çështjet e korrupsionit, që të dëgjohet zëri i opozitës, por është e kotë. Ka një çështje kryesore që duhet të na bashkonte: integrimi europian, por, fatkeqësisht, nuk na ka bashkuar. Me të gjitha kërkesat, insistimet, denoncimet tona, fatkeqësisht, Shqipëria nuk ka një platformë për integrimin, që t'i ulë të dyja palët bashkë dhe ky nuk është faji i opozitës, por i qeverisë.

Diskutimet që do të ndodhin sot për Komisionin e Prokurimit Publik do të kishin vlerë nëse ne do të kishim shembuj konkretë të luftës ndaj korrupsionit. Sot do të kishte vlerë çdo diskutim që do të ndodhte nëse qeveria do të fillonte të luftonte krimin e organizuar dhe të kishte një luftë konkrete ndaj drogës. Sot do të kishte vlerë çdo diskutim nëse ne do të fillonim të flisnim për dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, që pavarësisht se kemi plot 5 javë që e denoncojmë, nuk është marrë absolutisht asnjë masë dhe nuk është marrë seriozisht. Kur ne i denoncojmë këto çështje, kur ngremë zërin, nuk e bëjmë me kënaqësi. Unë personalisht nuk ndjej kënaqësi kur denoncoj krimin e organizuar dhe korrupsionin, kur shikoj dhe lexoj

që në raportet ndërkombëtare për Shqipërinë flitet dhe shkruhet si vendi që realizon pastrimin e parave. Nuk ndiej kënaqësi kur shikoj se në strategjinë e zgjerimit, në raportin e progresit ndaj vendit dhe në raportin e vendit që publikon çdo vit Komisioni European këto çështje që ne ngremë janë të shkruara e zeza në të bardhë, por ne duhet t'i themi këto. Është më mirë të jemi të drejtë, të jemi të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin dhe t'i ngremë këto shqetësime, sesa të duket se javën e fundit të qershorit qeverisë shqiptare do t'i vinë si të papritura vendimi i vendeve anëtare, nga njëra anë, dhe shqetësimet që janë ngritur në raportin e progresit të vendit, nga ana tjetër.

Për këto arsye e përsëris edhe një herë kërkesën e Partisë Demokratike, kërkesën e opozitës së bashkuar për aq kohë sa na ka mbetur deri më 28 qershor, që të ulemi bashkë dhe të fillojmë luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke hequr ministrin e Brendshëm dhe duke e marrë seriozisht këtë proces. Të mos gënjejmë veten që vendet anëtare do të na japin një mundësi se kemi shumë vjet që po përpiqemi. Vendet anëtare do të na japin një mundësi bazuar në rezultate dhe rezultatet vijnë vetëm në raste konkrete me luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Faleminderit!

Klevis Balliu – Për procedurë, ju lutem!

Erion Braçe – Urdhëroni!

Klevis Balliu – Faleminderit!

Sot jemi shumë afër qëndrimit të vendimit të Bashkimit European për hapjen e negociatave dhe nuk më besohet se mund të ketë një rend dite tjetër, veç për të diskutuar si mund ta lehtësojmë këtë qeveri, por, mbi të gjitha, Shqipërinë dhe shqiptarët, që, më në fund, t'i hapen negociatat, siç e meritojnë. Kjo gjë është e pamundur dhe jam i bindur se brenda këtij komisioni ka edhe kolegë socialistë që e kuptojnë këtë gjë, që e kanë evidentuar këtë gjë, që është e pamundur të kemi hapje negociatash në një moment ku ka një korrupsion galopant.

Mjafton të marrësh shembullin e kompanisë “Fusha”, që në një mënyrë të paprecedent ka marrë 129 tenderë, 90 milionë euro. Duhet 2 faqe për një kompani. Në një vend kaq të vogël sa Shqipëria është gjetur mënyra se si një personi, një individ, një pronari, t'i jepen 129 tenderë, 90 milionë euro. Do të kishit bërë tri teatro.

Më absurde është se aferat korruptive të shëmtuara, të cilat shkojnë direkt në dëm të xhepave të qytetarëve shqiptarë, nuk janë rastësisht. Kjo jo vetëm për shkak të denoncimeve të opozitës, por keni pasur Kontrollin e Lartë të Shtetit, që ka deklaruar se në vitin 2017 janë vjedhur 825,6 milionë euro, një shumë marramendëse për një shtet si Shqipëria, ku njerëzit

paguhen me 200 mijë në muaj, ku njerëzve u jepet ndihmë ekonomike nga 50 mijë lekë dhe atë vendoset t'ua hiqni gati 20-30 mijë qytetarëve.

KLSH-ja ka bërë 47 kallëzime penale. 90% e këtyre kallëzimeve penale janë mbyllur nga prokuroria, që sot, fatkeqësisht, është në duart tuaja. Kur them “në duart tuaja” e kam fjalën për një grup të asaj partie, sepse refuzoj të besoj që çdo socialist është i përfshirë aty. Ka shuma socialistë që nuk ndodhen tek tepsia e rilindjes, nuk ndodhen te takimet e ministrave të brendshëm me banditë, tek takimet ku vendoset që një pronar kompanie të marrë 129 tenderë 90 milionë eurosh.

Këto janë arsyet që larguan shqiptarët. Korrupsioni, vjedhja masive i la ata të pashpresë. U larguan dhe sot, fatkeqësisht, është një turp i madh. Nuk besoni opozitën? Besoni këto!

Jemi të parët për azilkërkues. E kemi kaluar Sirinë, që është në luftë me ISIS-in. E vetmja gjë që ju keni vërtetuar me këtë është se kjo maxhorancë është më e rrezikshme se ISIS-i për qytetarët e vendit të vet. Janë larguar më shumë qytetarë nga Shqipëria për të kërkuar azil, sesa nga Siria, vendet afgane. Jemi të parët, zotëri.

Si mund të rrimë ne gojëkryçur dhe të vazhdojmë me rendin e ditës? Ne mund ta bëjmë nëse nuk na intereson mirëqenia e qytetarëve shqiptarë, nëse nuk na intereson hapja e negociatave. Ne mund të vijmë këtu dhe të flasim për ligje që nuk zbatohet, mund të vendosim ligje që nuk kuptohen.

Për mua ky është një moment jashtëzakonisht shumë kritik dhe që do të vështirësohet më shumë, sepse Kryeministri sot, zoti Rama, vendos të marrë 600 mijë sirianë dhe kërkon të zëvendësojë popullin e Skënderbeut me popullin e sulltanit. Është turp! Të mos thuhet asnjë fjalë për këtë. 600 mijë sirianë.

Sa shqiptarë janë larguar në këta 5 vjet? 600 mijë shqiptarë. Po këta 600 mijë sirianë, ish-terroristë të ISIS-it, si do t'i kontrolloni ju, që keni 5 vjet dhe nuk po gjeni dot Balilin?

Në Komisionin e Ligjeve ministrja e Drejtësisë nuk pati asnjë fjalë të shkruar për luftën kundër krimit të organizuar, nuk pati një letër, një shkresë, sepse nuk ka pasur luftë. Nuk është luftuar kundër tyre, me ata është bashkëpunuar, me ata janë bërë para, me ata është vjedhur buxheti i shtetit, si rasti i këtij. 129 tenderë në një vend si Shqipëria. 129 tenderë duhet të kishte në 10 vjet këtu. 129 ia keni dhënë një personi të vetëm, 90 milionë euro.

Unë do t'i bëj thirrje Komisionit të Ekonomisë, si një nga më të rëndësishmit e vendit, të flasë për xhepat e qytetarëve, t'i rishikojë këto çështje, të kërkojë qoftë edhe në prokurori të rishikohen çështjet e kallëzimeve penale të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe mbi të gjitha, të pyetet ku kanë ikur 826 milionë euro. Kemi një ministër Financash që nuk ka dhënë një

përgjigje për këtë çështje. Kemi Komisionin e Ekonomisë, ku nuk u fol një herë për rënien e euros, pavarësisht se ka pasur që në datën 25 qershor, denoncime nga opozita, analiza nga analistë të ndryshëm, por sot nuk ka rëndësi se çfarë thotë opozita, se çfarë thonë analistët, se çfarë thonë intelektualët, se çfarë thonë artistët, se çfarë thonë ish-policët, sot ka rëndësi vetëm çfarë thotë zoti Rama. Zoti Rama sot është kryeartist, një njeri që nuk ka shitur një pikturë në jetën e vet pa u bërë Kryeministër, dhe kur u bë, ia blenë disa nga ata që e shoqëronin nga mbrapa, një njeri që nuk ka as arsimimin minimal për të folur për financat dhe nuk e kupton se çfarë është politika ekonomike, nuk e kupton çfarë është financa, nuk e kupton çfarë është politika. Ky njeri i dika të gjitha! Ky njeri del flet për futbollin, për artistët, për intelektualët...

Në qoftë se ne do të lejojmë të vazhdojë kështu, do të vijë një moment që, kur të duam ne dhe ju të bashkohemi për ta rikthyer Shqipërinë në rrugën e duhur, do të jetë e pamundur. Ç'do të bëjmë ne me 600 mijë sirianë këtu? Si do ta zgjidhim ne këtë? Përse duhet zëvendësuar populli i Skënderbeut me popullin e sulltanit, për t'i bërë qefin Erdoganit? Pse, për këtë punë jemi ne këtu? Për t'i bërë qefin Basharit, Putinit, a kujt tjetër?! Me kë jemi në aleancë, more zotëri, që ta dimë, se këtej një e dy: "Jemi me Perëndimin" dhe dhatë votën në OKB kundër Shteteve të Bashkuara. "Jemi me Perëndimin", por dalim në fotografi dhe flasim: "Vëllai, idhulli im Erdogani", të cilit i është vënë iksi.

Kështu do t'i hapim negociatat ne? Negociatat është shumë e thjeshtë për t'i hapur: t'i shpallet luftë krimit të organizuar, të fillojnë investimet publike, të ketë transparencë për investimet që janë bërë, që njerëzit që kanë vjedhur të marrin përgjegjësi. Këtu nuk po mban përgjegjësi as Saimir Tahiri, që e vetmja gjë që ka ngelur pa u treguar për të, është një fotografi me Moisiun duke mbajtur thesin në krah. Vetëm kjo ka ngelur. Edhe ky shpëtoi, edhe këtë e liruan. Edhe Mark Frrokun e liruan.

Mbi të gjitha, është absurditet dhe nuk e kuptoj... Kemi sot një ministër të Brendshëm, për të cilin, të them të vërtetën dhe të jem i sinqertë, nuk e di nëse ka lidhje personale me krimin e organizuar apo me narkotrafikun. Personalisht, nuk di të ketë ndonjë shtet në Europë që të ketë ministër të Brendshëm një person vëllai i të cilit është në burg. Kjo është arsyeja thelbësore se pse ky zotëri duhet të largohet. Është në konflikt të plotë interesi.

Të mos harrojmë një gjë: burgjet janë për rehabilitim. Agron Xhafaj nuk ka qenë në burg dhe nuk është rehabilituar kurrë. Si mund të vazhdojmë ta mbajmë?

Si do t'i hapim negociatat? Çfarë do t'u themi atyre kur të na pyesin: "Si e keni sistemin e drejtësisë?" Çfarë do t'u themi, që e kemi shumë mirë, por e kemi pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Laftë? A ka shtet në botë që nuk e ka sistemin e drejtësisë?

Kemi parë shtete që nuk kanë pasur qeveri, që mund të kenë kaluar dy ditë apo tri ditë në krizë, por të mos ketë sistem drejtësie një shtet?! Është absurde!

Dhe asnjë këtu nuk po thotë një fjalë. Pse duhet t'i thotë vetëm opozita këto? Pse nuk thotë një deputet i maxhorancës: "Ore, prit një herë, pse nuk është kjo Gjykata Kushtetuese? Çfarë u bë këtu? Çfarë po ndodh me këtë Gjykatën e Lartë, se janë 15 mijë dosje? Kush do t'u përgjigjet qytetarëve shqiptarë? Për këto 825 milionë euro që kanë ikur nga buxheti, kush do të mbajë përgjegjësi?"

Ju keni njerëz që ju kanë votuar. Unë jam deputet i Pogradecit. Pogradeci ka 94 mijë banorë dhe 12% e tyre janë me ndihmë ekonomike.

Kush do t'i thërrasë mendjes këtu? Si ka mundësi që në një qytet turistik 12% e popullatës janë me ndihmë ekonomike? Këtu ka diçka që nuk shkon, zotëri! Pyete Berishën para 5 vjetëve. Sot pyes Edi Ramën, që ka 5 vjet që qeveris. Dua të di, çfarë ka bërë? Dua të shkel një rrugë dhe të them: "Këtë rrugë e ka bërë ky Kryeministër." Dua të shoh një rritje, një zhvillim ekonomik. Dua të shoh një investitor të huaj.

Më thoni emrin e një investitori të huaj që keni sjellë këtu? Se flisni për qeverinë e Berishës, por mbaheni akoma me paratë e qeverisë së Berishës, me TAP-in dhe Devolli. Me TAP-in dhe Devollin jeni mbajtur për 5 vjet.

Doni të flisni për qeverinë e Berishës? Flisni, por nuk keni ç'flisni! Nuk keni ç't'i thoni. Po mbaheni me paratë dhe investimet e huaja të qeverisë "Berisha".

Ku i keni investitorët e huaj? Nuk janë investitorë të huaj ata 600 mijë sirianë. Se e presim edhe këtë, të na dalë një lajm te ERTV-ja: "Afrohen 600 mijë investitorë të huaj nga Siria."

Bëhuni pak më seriozë! Rikthejuni problematikave të qytetarëve!

Po largohen njerëzit, po ikin nga vendi, po bëhemi të padurueshëm për ta.

T'u rikthehemi investimeve publike për njerëzit: të shtrohet një rrugë, të ulen taksat, se kanë shkuar në kupë të qiellit dhe nuk po i përballojnë dot njerëzit, se nuk përballohen dot 400 mijë lekë taksa në muaj me 250 mijë lekë rrogë, more zotëri! Është absurde! Matematikisht është e pamundur.

Çfarë t'u themi njerëzve? Të vrasin veten ata?

Vendoset një taksë, taksa progresive. Dështoi? Hajde ta ndryshojmë!

T'u rikthehemi investitorëve të huaj dhe t'u themi: "Afrohuni!" T'ua ulim taksat atyre, që të vijnë.

Kthehuni tek taksa e sheshtë, se funksionoi. Në kohën kur Greqia ishte në krizë ekonomike, ky vend vazhdonte të lulëzonte. Në kohën kur investitorët e huaj po largoheshin

nga Bashkimi European, u afruan këtu. Them se po lulëzonte, sepse u liberalizuan vizat, zoti Kryetar, dhe nuk ishte gjë e vogël. Meritë për këtë ka edhe Partia Socialiste dhe nuk e mohoj, se nuk kam ardhur këtu për të bërë propagandë politike.

Edhe po të hapen negociatat, në daçi, quajeni atë datë si “data e Edi Ramës”, nuk më intereson. Mua më intereson vetëm të hapen negociatat. Se e përdorni politikisht, kjo është puna juaj, unë kam zero interes. Quajeni “data e Edi Ramës” dhe festojeni çdo vit, por të hapen negociatat.

Nuk hapen negociatat kështu, se nuk ka një shtet të Europës që të merr seriozisht pa Gjykatë të Lartë dhe pa Gjykatë Kushtetuese; 825 milionë euro të vjedhura; një individ merr 90 milionë euro, 129 tendera. Nuk punohet kështu.

Vëllai i një ministri të Brendshëm është në burg për narkotrafik në Itali. Shko dhe takojë ministrin e Brendshëm të Italisë! Çfarë do të pyesësh? Çfarë do të flasë?

Jemi akoma në kohë për të bërë kthesë. Sot (dhe këtë nuk e them unë, e thotë kjo), edhe një herë po e përsëris, kjo maxhorancë është kthyer më e rrezikshme për qytetarët e vet sesa ISIS-i për qytetarët sirianë. Kaq duhet të mjaftojë, që ju të bëni llogaridhënie të vërtetë, jo llogaridhënie me ata që i vendos ai atje. T’i thoni: “O zotëri, si ka mundësi që ikën këta?! Se të ERTV-ja del Shqipëria në lulëzim, te ERTV-ja kemi rritje ekonomike, te ERTV-ja kemi zhvillim ekonomik, te ERTV-ja arrestohen banditë. Në të vërtetë, faktet tregojnë ndryshe.

Pra, edhe një herë, ju bëj thirrje, që nëse e keni në plan, të hapen negociatat, Në qoftë se do të punoni edhe ju kundër, siç punon Kryeministri juaj kundër hapjes së negociatave, se po u hapen negociatat ai nuk luan dot me drogën... Ai pa drogë nuk rri dot as në pushtet, as në qeveri, as në parti. Ai është me hiç po i iku droga, sepse drogën Edi Rama e ka kriter bashkëpunimi. Prandaj, sot shumë figura të rëndësishme të Partisë Socialiste kanë dalë jashtë loje, sepse nuk kanë kontakte me drogën.

Faleminderit!

Erion Braçe – Natyrisht, e gjithë kjo që po bëni është një histori e dhunshme, që përsëritet jo prej një muaji e një jave, siç tha zonja, por prej dy muajsh. Natyrisht, nuk ka asnjë lloj lidhjeje me procedurën.

Meqë të dëgjova me vëmendje dhe mbajtja edhe shënime, dua të të them disa gjëra.

Së pari, këtë komision nuk e përdor dot as ti, as unë dhe askurrkush, për t’i vënë gjobë cilësdo kompanie që operon në tregun shqiptar, duke filluar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, gjobë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, po ta them unë.

Pra, ky komision, po ta përsëris edhe një herë, nuk mund të përdoret për t'i vënë gjobë nga këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, unë të dëgjova, më dëgjo edhe ti mua!

...cilësdo kompanie, pavarësisht emrit që ka dhe pavarësisht ku nis: nis djathtas, si kunati i Bardhit të Farkës, apo nis majtas, si, ku ta di unë, kushëriri i parë i filanit. Dakord? Kjo është e para. Ky është standardi i këtij komisioni dhe, në qoftë se doni të flisni në këtë komision, do të respektoni këtë standard.

E dyta, kur vjen këtu të flasësh apo të akuzosh këtë komision se nuk paska folur për këtë, për atë, apo për këtë të KLSH-së apo atë të KLSH-së e të tjera me radhë, minimumi, duhet të lexosh. Kjo është gjëja më elementare.

Po të kishe lexuar raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, do të kishe kuptuar se vlera prej 826,5 milionë eurosh, të cilën e verifikuam ne në këtë komision, ku nuk ishit ju, madje kryetari i KLSH-së ju falënderoi që shkëlqyet me mungesën tuaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi? Të lutem, ta mbaroj unë!

...përbëhet, po ta lexosh (shko tek tabelat se e ke më të thjeshtë), nga mungesa e vendosjes së gjobave për makinat e sekuestruara, që operonin në mënyrë të paligjshme si lojëra fati, të sekuestruara për këtë gjë. Dhe këtu, pa asnjë lloj diskutimi, nga ky komision, nga kjo anë e komisionit, është mbajtur një qëndrim shumë i qartë, se janë gati 500 milionë euro vetëm nga kjo punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O zotëri, a ka mundësi të mbaroj unë? Përndryshe, mbledhja mbyllet këtu dhe nuk vijon më. Meqë vini këtu të gënjeni, heshtni kur ballafaqoheni me fakte!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hape tabelën e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe në qoftë se nuk të funksionon kjo që po të them unë, atëherë nuk di të lexosh.

E dyta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thatë: "Vjedhje."

Klevis Balliu – Vjedhja dëm ekonomik është.

Erion Braçe – Ke një problem shumë të madh ti, që i ke në krah ata që flasin, i dëgjon dhe i transformon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mbaj shënime kur flisni ju. Po ta them edhe një herë, tha: “Vjedhje, 826,5 milionë euro vjedhje”. Po ta përsëris, 500 milionë euro të këtij 856-milionshit janë gjoba të pavendosura për makinat elektronike të lojërave të fatit, të sekuestruara nga agjencitë ligjzbatuese të shtetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E dyta, mbi 200 milionë euro janë taksa të pambledhura deri tani, të paarkëtuara nga disa kompani naftë, përfshirë “Bankers Petroleum”, përfshirë “Stream Oil” dhe disa të tjera, të paarkëtuara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse nuk të lë ti, se unë i çoj në gjykatë dhe ti, bashkë me Saliun tënd, dolët atje publikisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...dhe nuk latë llaf pa thënë: “Po sulmoni biznesin privat, po sulmoni investitorët e huaj.”

(Debate pa mikrofon)

Juve nuk ju intereson si arkëtohen paratë publike. Nuk ju intereson se si funksionojnë klientët. Kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Debate pa mikrofon)

A ka mundësi të mbaroj unë?

Klevis Balliu – Zoti Kryetar, çfarë justifikimi keni për 129 tendera?

Erion Braçe – Ja, se po vij atje, te kunati i Bardhit të Farkës.

Edmond Spaho – Zoti Kryetar, e dini se çfarë po thoni, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Zoti Spaho, a ka mundësi të mbaroj unë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, zoti Spaho, jo. Unë të di për filogjerman ty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos u bëj sallatë ruse, të lutem!

Tani, po ta them edhe një herë tjetër, është dëm ekonomik i zbuluar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të cilin organet tatimore fiskale të shtetit i kanë kallëzuar kompanitë penalisht, i kanë kallëzuar edhe nga pikëpamja civile dhe gjyqet vazhdojnë, janë atje. Por kur

ju nuk vinit në mbledhje të pyesnit kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, natyrisht që kështu do të flisni. Kur nuk e merrni mundimin as të lexoni, për gjëra që doni të flisni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk i ke të lexuara, se po t'i kishe lexuar do ta kishe kuptuar atë gjë.

Klevis Balliu – Të gjitha janë të printuara, zoti Kryetar. Unë nuk flas në ajër këtu. Unë flas me letra me dokumente....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – E treta...

Klevis Balliu – Më jep arsyetimin!

Erion Braçe – A ka mundësi të mbaroj unë?

Klevis Balliu - Më fal, vazhdo!

Erion Braçe – I kërkoje këtij komisioni, që t'i kërkojë prokurorisë të rihapë kallëzimet e mbyllura të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Së pari...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...meqë ia kërkoje këtij komisioni dhe meqë unë jam kryetari i këtij komisioni dhe e marr seriozisht Kontrollin e Lartë të Shtetit, e kam ndjekur këtë çështjen e kallëzimeve dhe, për të thënë të drejtën, nga dhjetori i vitit që shkoi e deri tani, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kallëzuar në prokurori vetëm 5 çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Djalë, edhe një herë, nga dhjetori...

Klevis Balliu – Sa për “djalë”, shko dhe shikoi nga i ke djemtë, por...

Erion Braçe – Dakord. Ndjesë!

Deputet i nderuar, dëgjo pak, të lutem!

Nga dhjetori i vitit që shkoi, kur erdhi kjo prokurorja, që e identifikoni si tonën, e deri tani, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kallëzuar vetëm 5 çështje. 2 të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur nuk di gjë, mos e vazhdo më!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbaroj unë njëherë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbledhja mbyllet këtu.

Klevis Balliu – Të fala mbylljes dhe kujt të duash!

Tani përgjigju këtyre letrave këtu.

Erion Braçe – Nuk bëhet më mbledhje sa herë të jesh ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevis Balliu - Erion, më shumë shanse kam unë të hyj këtu brenda, se të hysh ti dhe ti e di shumë mirë.

Erion Braçe – E shohim, pa merak!

(Debate pa mikrofon)

Edmond Spaho – Zoti Braçe, edhe dje e mbylle mbledhjen në këtë mënyrë, edhe sot. Nuk është serioze.

Erion Braçe - E dëgjova për 20 minuta. I ndërhyra? Nuk i ndërhyra asnjëherë.

(Diskutime pa mikrofon)

(Pas ndërprerjes)

Erion Braçe – Rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë.

Vazhdojmë me seancën dëgjimore.

E para për t’u dëgjuar nga ky komision është zonja Kozeta Vuksanlekaj.

E nderuar zonjë, mirëdita!

Ndodheni para këtij komisioni në përputhje me ligjin “Për prokurimin publik”, veçanërisht nenin 19.2, që i jep të drejtën këtij komisioni që të organizojë seanca dëgjimore me propozimet e ardhura na KM-ja për funksionin e anëtarit të KPP-së.

CV-ja juaj është shpërndarë, e kanë të gjithë kolegët deputetë përpara. Do të donim një prezantim tuajin që lidhet drejtpërdrejt me atë që ju mendoni, në raport me prokurimet publike dhe veçanërisht edhe me idenë tuaj për funksionimin e KPP-së.

Fjala për ju, 10 minuta dhe pastaj kolegët, nëse kanë pyetje, mund t’jua adresojnë dhe, natyrisht, jeni e lutur të na jepni disa përgjigje.

Kozeta Vuksanlekaj – Përshëndetje, të nderuar deputetë!

Emri im është Kozeta Vuksanlekaj. Arsyen kryesore pse kam aplikuar në këtë pozicion do ta shprehja me një citim biblik “Ai që mbjell drejtësi, ka një shpërblim të madh”. Këtu nuk e kam fjalën vetëm për vete, por për çdo person që zbaton ligjin dhe të drejtën, kontributi i tij përbën një farë që hidhet në tokë dhe nesër mund të bëhet një pemë me rrënjë të thella dhe të japë shumë fryte.

Për hir të së vërtetës sa herë që aplikoj në pozicione të tilla, ndihem para jush si para një muri të lartë që mund të kapërcehet, për vetë faktin se nuk kam mbështetje as majtas dhe as djathtas dhe kjo në aspektin formal ligjor është një pikë e fortë, por në aspektin real është një pikë e dobët.

Para se të deklaroj vizionin tim do të them që realizimi i vizionit tim, por edhe i çdo kandidati tjetër, varet shumë nga vullneti juaj për të zgjedhur njerëz me integritet, të aftë profesionalisht dhe që të garantojnë pavarësinë e këtij institucioni.

Në lidhje me vizionin tim personal, para se të kaloj te pozicioni që kam aplikuar, do të thosha se mund ta ndaj në dy kahe: vizioni institucional dhe vizioni profesional.

Për sa i përket vizionit institucional, duke mos qenë një hallkë e piramidës institucionale, gjithmonë mbetesh në konturet e mosrealizimit të tij, por thjesht mund të hedhësh në letër studimet shkencore, duke realizuar problematikat, duke ndërthurur ligjin me realitetin.

Megjithatë, do të thosha se gjatë eksperiencës sime 15-vjeçare vetëm në vitet 2007-2011 kam dhënë një kontribut në vizionin institucional për vetë faktin se kam pasur një titullar shumë vizionar, që arriti ta shndërronte Këshillin e Qarkut Shkodër në një model në të gjithë Shqipërinë, duke investuar te kapitali njerëzor, duke krijuar në zyrë projektsh me të rinjtë, që kishin mbaruar studimet jashtë shtetit dhe ishin shumë të aftë profesionalisht dhe arritën të sillnin fonde europiane nga programe të ndryshme.

Për sa i përket vizionit individual ose profesional, them se kam një prirje të natyrshme për të ndarë eksperiencën time profesionale me kolegët, sidomos me stafin që kam në varësi. Duke vlerësuar ose nxitur mendimin e çdo personi, arrij të nxjerr më të mirën në çdo lloj ambienti zyrtar, jo vetëm përmes shembullit personal, por edhe duke ndarë vlerat që unë besoj dhe i zbatoj.

Në lidhje me këtë detyrë, përveç përgatitjes profesionale, një element qenësor është edhe integriteti. Po them një paragraf të shkurtër për çështjen në kuptimin vizionar: “Pasuria e fituar në mënyrë të padrejtë do të katandiset në pak gjëra, por kush e fiton me mund, ajo do t’i shtohet”.

Unë e besoj, përpiqem dhe mendoj se çdo njeri që është i zgjuar, që di jo vetëm të mendojë për interesin publik, por edhe për veten ose për kolegët, duhet ta shikojë në këtë këndvështrim integritetin në çdo lloj detyre që ushtron.

Në lidhje me përgatitjen akademike dhe profesionale, megjithëse nuk ndihem komode të flas për veten, sepse është më mirë të flasë goja e një tjetri dhe jo goja jote, në aspektin personal do të thosha me një fjali të thjeshtë se jam një person që e do shumë diturinë, por

sa më tepër rritet njohuria aq më tepër e kupton sa e vogël je para tërësisë së saj. Jam një person që e dua shumë punën, jam e përkushtuar edhe në momentet kur kam pasur relacione jopozitive me titullarë, gjithmonë jam përpjekur të respektoj hierarkinë, duke qenë shumë bindëse, argumentuese në çdo lloj çështje të caktuar.

Kam mbaruar studimet e larta në vitin 2000. Në vitin 2011 kam mbaruar në Universitetin e Prishtinës, kam fituar një bursë për mesatare të lartë, master shkencor “Për të drejtën kushtetuese dhe administrative”. Jam në fazën e mbrojtjes së temës së doktoratës në Universitetin e Prishtinës. Kam zhvilluar trajnime të ndryshme, kam një eksperiencë të gjatë. Gjithmonë kam punuar në sektorë të vështirë deri në vitin 2008 në Sektorin e Urbanistikës Ligjore, ku në atë periudhë këshilli i qarkut kishte kompetenca shumë të gjera për sa u përket lejeve ku përfshiheshin dy njësi vendore. Nga viti 2009 kam punuar në sektorin e prokurimeve publike, në sektorin e projekteve, shërbimeve dhe transportit.

Një profesion, i cili më ka pëlqyer shumë është ai i pedagoges, e kam ushtruar për një vit në një universitet privat, ku përveç faktit se ishin 300 studentë dhe vinin vetëm 30% e tyre, 60% mbetën dhe titullari i institucionit nuk ma rinovoi kontratën.

Mendoj se për pozicionin që aplikoj do të jap një kontribut të rëndësishëm, pavarësisht se nuk i di problematikat duke mos e njohur nga brenda, por nga jashtë, dy shtylla themelore janë: pavarësia dhe integriteti, që garanton pavarësinë e këtij institucioni.

Erion Braçe- Zonjë, mbaruat?

Kozeta Vuksanlekaj Frangaj - Po.

Erion Braçe - Faleminderit!

Ka pyetjet nga kolegët deputetë të komisionit në lidhje me zonjën?

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonjë!

Dëgjova me vëmendje prezantimin tuaj. Nuk i gjej shumë me vend fjalët në fillim: “Nuk kam miq të njohur as majtas dhe as djathtas”, gjithsesi ky është mendimi juaj. Këtu jeni në Komisionin për Ekonominë dhe kjo gjë nuk ka rëndësi.

Kozeta Vuksanlekaj Frangaj - Më falni, por nuk po ju dëgjoj mirë.

Arben Pëllumbi – Dëshiroj t’ju pyes për një botim tuajin të vitit 2009 “Për prokurimet elektronike që rrisin efikasitetin në administratë”, çfarë mendoni sot për sistemin dixhital që ka Komisioni për Prokurimet Publike? A keni një mendim tuajin sesi kjo mund të zhvillojë akoma më shumë rritjen e performancës së këtij komisioni?

Kozeta Vuksanlekaj Frangaj – Për sa i përket dixhitalizimit për Komisionin e Prokurimit Publik apo për prokurimet elektronike në përgjithësi?

(Zoti Arben Pëllumbi ndërhyr pa mikrofon)

Unë mendoj se ishte një arritje shumë e madhe në vitin 2009, ku u aplikua prokurimi elektronik. Unë kam bërë edhe një studim në lidhje me efektivitetin për sa i përket kursimit të kodeve publike të këtyre procedurave elektronike.

Për sa i përket përsosjes problematikat që vërej sot janë cilësia e punimeve, duke aplikuar me vlera shumë të ulëta, duke qenë prioritet kursimi i fondeve publike, në shumicën e rasteve fitojnë firma me një çmim shumë të ulët. Mendoj se duhet të gjendet një ekuilibër i duhur, të mos jetë vlera më e ulët, por mesatarja, pra të jetë fitues ofertuesi që është më afër mesatares aritmetike të ofertave. Të jetë një formulë tjetër, sepse duke aplikuar me çmimin më të ulët gjithmonë do të cenohet cilësia e punimeve. Këtë e kam bindje. Risi tjetër ishte edhe përcaktimi, nëse e shikon në aspektin e supervisorit deri para një viti aplikonin me vlera ku edhe për 200 lekë kanë vjedhur kontratën supervisorët, sepse vlera më e ulët vinte nga Tirana me 200 lekë për të kontrolluar dhe për të mbajtur përgjegjësinë e zbatimit të punimeve, ndërkohë me ndryshimet e reja ligjore është aplikuar një kufi minimal dhe maksimal që është i rëndësishëm, por mendoj se duhet të bëhet një reformë në këtë drejtim dhe të gjendet një formulë tjetër.

Erion Braçe - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Zonjë, shumë faleminderit për prezencën tuaj! Për prezantimin tuaj komisioni do të marrë vendimet respektive. Jeni e lirë të largoheni.

Kozeta Vuksanlekaj Frangaj - Faleminderit!

Erion Braçe - Të vijë kandidati tjetër.

Mirëdita!

Zoti Kosta, ndodhemi këtu për shkak të ligjit “Për prokurimin publik” dhe së drejtës që rrjedh prej tij, për të organizuar seancën dëgjimore nga ky komision, lidhur me propozimin e Këshillit të Ministrave për një vend anëtar në Komisionin e Prokurimit Publik.

Do të donim një prezantim tuajin lidhur me atë që ju mendoni për prokurimet publike, e natyrisht edhe për Komisionin e Prokurimit Publik, pasi CV-ja juaj u është shpërndarë të gjithë kolegëve deputetë. Pra, nga pikëpamja personale, mendoj unë, gjithsecili e ka përpara aktivitetin tuaj të gjatë gjithë këtyre viteve. Ndërkohë, na intereson edhe një vizion juaj lidhur me prokurimet publike, e natyrisht edhe për Komisionin e Prokurimit Publik dhe funksionimin e tij.

Jeni i lutur që të bëni prezantimin tuaj! Pastaj, nëse kolegët deputetë kanë pyetje, do t’ju adresojnë, dhe ju jeni i lutur të na jepni disa përgjigje.

Fjala për ju!

Gjergji Kosta – Faleminderit! Përshëndetje të gjithëve!

Unë quhem Gjergji Kosta, dhe jam këtu në cilësinë e kandidatit për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik.

Fillimisht dëshiroj të bëj një prezantim të shkurtër të edukimit tim universitar e të eksperiencës sime profesionale.

Kam kryer studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë. Kam kryer disa kualifikime, të cilat kanë të bëjnë me çështje të sistemit të së drejtës, me metodat e hartimit të legjislacionit, me mënyrën e vlerësimit të pasurive, si dhe kam kryer specializim për të drejtën tregtare.

Për sa i përket eksperiencës sime profesionale, ajo përfshin një hark kohor prej 18 vjetësh. Gjatë kësaj periudhe kam qenë pjesë e administratës qendrore dhe kam punuar në disa institucione: në Ministrinë e Financave, të Ekonomisë, të Industrisë, të Mbrojtjes, si dhe në zyrën qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Pjesë e kësaj eksperience është edhe ajo e konsulentit ligjor në projekte të Bankës Botërore dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Si nëpunës i administratës shtetërore kam ushtruar funksione publike në të gjitha nivelet, konkretisht specialist në Ministrinë e Financave, ku mbuloja ligjshmërinë dhe procedurat e privatizimit, specialist në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ku mbuloja ligjshmërinë dhe koncesionet, shef i sektorit të prokurimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, ku mbuloja procedurat e prokurimit të Forcave të Armatosura; drejtor i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Ekonomisë, ku përveç funksionit bazë kisha në varësi edhe sektorin e prokurimeve; drejtor në Drejtorinë Juridike në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Si pjesë e po kësaj administrate, por me cilësinë e funksionarit të kabinetit, kam qenë këshilltar në kabinetet e disa ministrive, përfshi këtu edhe postin e drejtorit të kabinetit.

Qenia në këto pozicione të nëpunësit civil, si dhe të funksionarit të kabinetit, më kanë dhënë mundësinë të fitoj përvojë, profesionalizëm, si dhe të tregoj cilësitë individuale në proceset drejtuese e vendimmarrëse.

Lidhur me aplikimin si kandidat për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik, unë dëshiroj të them se interesi për sektorin publik ka qenë dhe është një konstante e përhershme e imja. Aty kam krijuar profilin tim profesional dhe kam shfaqur integritetin tim moral. Duke parë kriteret që ligjvënësi ka përcaktuar me ligj, më pas të detajuara, vura re se ato fokusohen

tek diploma jurist, kualifikimet, përvoja në punë, përvoja në pozicione drejtuese, si dhe përvoja në prokurime.

Unë mendoj se këto kritere i plotësoj maksimalisht, sipas CV-së dhe metodës së vlerësimit të jetëshkrimit, e për rrjedhojë aplikova për kandidat për Komisionin e Prokurimit Publik.

Funksioni i anëtarit si pjesë e trupës së Komisionit të Prokurimit Publik, funksion për të cilin unë po prezantoj kandidaturën time, mbart përgjegjësi specifike. Kjo diktohet nga fakti se sistemi i prokurimit është një ndër instrumentet kryesorë, i cili e ndihmon qeverinë të arrijë objektiva ekonomike, sociale nëpërmjet efektivitetit të mirëpërdorimit të fondeve publike.

Veçoj këtu faktin se komisioni është mbrojtës i interesit publik për të siguruar interesat e ligjshme të operatorëve ekonomikë përballë autoriteteve kontraktuale.

Në referencë të ndryshimeve të fundit ligjore, Komisionit të Prokurimit Publik i është dhënë një shkallë e lartë pavarësie për të garantuar veprimtarinë e tij administrative vendimmarrëse. Po kështu është zgjeruar edhe baza e parimeve, mbi të cilat mbështetet komisioni për të dhënë vendime. Përveç parimeve të përzgjedhjes, kemi edhe parimet e qëndrueshmërisë, ligjshmërisë, shpejtësisë, eficiencës dhe kontradiktualitetit.

Në kontekstin e këtyre ndryshimeve përmbajtësore, natyrshëm komisioni do të duhet të formulojë objektiva që u përgjigjen risive ligjore dhe pozicionit të tij në fushën e prokurimeve.

Në këndvështrimin tim, disa nga këto objektiva mund të jenë: objektiv i përhershëm dhe themelor është mbrojtja e interesit publik. Ky objektiv ka të bëjë me detyrimin e Komisionit të Prokurimit Publik për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor vendimmarrës, duke bërë të mundur që operatorët ekonomikë të ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore përmes ankimimit, në rast të veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve kontraktore që cenojnë ligjshmërinë e procesit të prokurimit, por në çdo rast, ky proces nuk mund të jetë në dëm të interesit publik.

Nëse flasim për objektiva, do të duhet të hartohet një dokument, në të cilin përcaktohen piketat që do të arrihen, standardet në drejtim të afateve kohore dhe metodave të vlerësimit.

Thënë ndryshe, do të bëhet i mundur vlerësimi i matshëm i veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik do të identifikohet si organi referues i ligjshmërisë në procesin e prokurimit. Ajo do të kryejë unifikimin e praktikave për të gjitha hallkat e procesit. Kjo do të thotë se Komisioni i Prokurimit Publik nuk do të shqyrtojë vetëm ankesat.

Unifikimi i praktikave dhe përdorimi i tyre si indice për të ndryshuar, apo përmirësuar eventualisht aktet ligjore dhe nënligjore, do të ishte një objektiv me rëndësi për rritjen e transparencës për t'u ofruar të thëna palëve të interesuara, duhet krijimi i një baze *online* për të marrë në kohë reale informacion, që deri tani nuk ka qenë i aksesueshëm. Kjo do të ishte e përshtatshme sidomos për elementet procedurale dhe vendimet e KPP-së. BB-ja ka projekte me institucionet tona, që kanë të bëjnë me nxitjen e transparencës në prokurimet publike dhe KPP-ja duhet të përfitojë nga këto projekte, pasi transparenca është një mënyrë për të rritur qartësinë dhe sigurinë për të gjithë aktorët në proces dhe u lejon atyre të ndërrohen në varësi të rrethanave joligjore. Transparenca rrit përgjegjshmërinë dhe ushtron presion mbi vendimmarrësit, që t'i përmbahen ligjit. Duke konsideruar që fjalët kyçe janë “profesionalizëm” dhe “transparencë”, do të mendoja që rritja e kapaciteteve profesionale të trupës vendimmarrëse të KPP-së dhe stafit që përgatisin praktikën, duhet të jetë një objektiv i përhershëm, për të siguruar një proces ligjor dhe një vendim të drejtë. Direktivat e parlamentit europian dhe të Këshillit të BE-së për problemet publike dhe kontratat koncesionare, si dhe udhëzuesit e tyre përkatës janë një ndihmesë reale për të gjithë zyrtarët që përfshihen në sistemin e prokurimit publik. Në cilësinë e organit me të lartë në fushën e prokurimeve, KPP-ja duhet të bashkëpunojë me të gjitha institucionet përkatëse për skanimin e problematikave në procesin e prokurimit, me qëllim që t'u japë konkluzione dhe orientime të sakta autoriteteve kontraktore, apo të propozojë ndryshime të akteve ligjore në funksion të mirëfunksionimit të sistemit të prokurimit publik.

Ruajtja dhe garantimi i konkurrencës është një çështje kyçe për arritjen e rezultateve eficiente dhe ekonomike gjatë prokurimit. KPP-ja duhet të ushtrojë autoritetin e saj në aspektin vendimmarrës dhe në atë rregullator kundër çdo veprimi dhe mosveprimi, që kufizon pjesëmarrjen e operatorëve në proces, shmang apo ngushton konkurrencën. Mbrojtja e konkurrencës është gjithashtu një kërkesë për ruajtjen e barazisë dhe ndalimin e diskriminimit.

Në referencën e direktivës së BE-së për prokurimin KPP-ja mund të bëjë edhe seanca diskutimi të drejtpërdrejta me entet prokurore dhe palët, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për problematikën, me synim reduktimin e ankimeve. Por ai mund të përdorë këto bashkëbisedime edhe për të bërë me dije instrumentin e ankimit, që garanton

ligjshmërinë e sistemit. Natyrisht që mund të ketë edhe objektiva të tjera, por unë këto mendova te evidentoj për këtë prezantim.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Unë e dëgjova me shumë vëmendje prezantimin tuaj dhe falë eksperiencës që keni doja të bëja vetëm një pyetje. Cilat mendoni ju se mund të jenë dy apo tri problemet që ju shqetësojnë më shumë sot për prokurimet? Çfarë ideje keni se mund të bëni ndryshe?

Gjergji Kosta – Në pikëpamjen time problemi thelbësor më duket se është profesionalizmi. Një nga gjërat më të rëndësishme që kam vënë re gjatë eksperiencës sime është shpeshësia e ndryshimit të individëve, të cilët merren drejtpërdrejt me procesin e prokurimit, specialistëve apo përgjegjësve të sektorit, të cilët kanë gjithmonë nevojë për trajnim apo për rritje profesionalizmi. Gabimet e tyre shfaqen në mënyrë zinxhir në të gjitha hallkat e procesit deri në vendimmarrje përfundimtare. Unë do të preferoja që këta individë të trajnoheshin dhe të ishin në mënyrë të përhershme në pozicionet e tyre të punës, me qëllim që të fitonin një eksperiencë të vazhdueshme, që të jenë të aftë për të përballuar çdo sfidë të këtij lloji sektori. Pjesa tjetër, që mua do të më dukej e arsyeshme për ta ndryshuar, është përafrimi me direktivën hap pas hapi, pasi dihet që legjislacioni me të cilin ne operojmë është ai i BE-së dhe, për pasojë, nëse ti përvetëson në shkallë maksimale atë lloj legjislacioni, atëherë ti ke përvetësuar legjislacionin vendas në këtë rast, pra ke bërë detyrën nga pikëpamja profesionale në mënyrën më të mirë të mundshme që mund të bëhet.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

A keni pyetje zoti Bushati?

Ervin Bushati – Po, kam një pyetje. Shoh CV-në që është e plotë me pjesëmarrje dhe me poste në administratën shtetërore, por ka një boshllëk këtu nga viti 2011 deri në vitin 2014. Keni qenë në sektorin privat?

Gjergji Kosta – Jo, kam pasur një kontratë konsulence në Bankën Botërore për një projekt me temë “*Agricultural Service Project*” për krijimin e tregjeve me shumicë, pastaj kam pasur një ndërprerje dhe nuk jam marrë as me sektorin publik as privat.

Ervin Bushati – Një pyetje tjetër. Ne e kemi kthyer këtë proces herën e parë sepse kërkojmë me të vërtetë të kemi njerëz me integritet të lartë dhe, në fakt, edhe kandidaturat kanë qenë shumë më të mira herën e dytë dhe procesi ka shkuar shumë më mirë.

Cili mendoni se është problemi i vërtetë me prokurimet publike në këto vite?

Dje kishim këtu drejtorin e Prokurimeve të Autoritetit Rrugor dhe si problem kryesor ai ngriti mungesën e financimit për vepra të rëndësishme publike, të cilat pengojnë ekonominë shqiptare dhe, patjetër, janë pengesë e madhe edhe për qytetarët, për jetën, për ekonominë, si për shembull, bajpasi i Fierit, rrugë të tjera të mëdha ose rruga nga Plepat në Rrogozhinë, që ka 10 vjet për t'u zbatuar...

Shoh se keni qenë edhe këshilltar juridik në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Ekonomisë dhe Zhvillimit të Tregtisë, pra pikërisht aty ku mund të ketë qenë nyja kryesore, ku mund t'u ishte dhënë një impakt apo një shtysë këtyre projekteve për të ecur shumë më mirë.

Ku mendoni se gabohet në kontraktim? Ku e kemi ne si shtet problemin? Se ta hedhësh fajin nga një autoritet që bën kontraktimin, te qeveria dhe qeveria pastaj e kthen në çështje politike...

Ku është problemi dhe çfarë mund të bëjmë më mirë në të ardhmen, që të mos kemi probleme të tilla në rrugë apo në vepra të rëndësishme infrastrukturore, që shkojnë mbi 10 vjet?

Gjergji Kosta – Kuptova.

Unë po e shoh teknikisht pyetjen, nëse mund të përgjigjem në këtë aspekt.

Duke qenë se në Ministrinë e Ekonomisë kam mbuluar pothuajse të gjitha nivelet e administratës publike me detyrat që kam pasur, jam marrë posaçërisht edhe me hetimin konkensionar. Ajo që kam konstatuar është se shteti shqiptar ka mangësi shumë të mëdha në kapacitete për të kryer planin e fizibilitetit. Domethënë, në një procedurë konkensionare, pjesa kryesore dhe nevralgjike është fizibiliteti i propozimit, të pakërkuar apo të kërkuar, nuk ka rëndësi, sipas procedurës. Kjo mangësi e profesionalizmit, le të themi, është mbushur me propozimin e pakërkuar, duke u sjellë nga individët apo shoqëritë aplikuese.

Në momentin kur ai të sjell të gatshëm një propozim të pakërkuar dhe ti nuk ke kapacitetet për ta vlerësuar, fillon problemi thelbësor, i cili pasqyrohet pastaj në të gjithë procesin. Nëse ti ngre një kapacitet në një institucion me kapacitete, që vlerësojnë në mënyrë të drejtë dhe të vërtetë propozimin e pakërkuar për fizibilitetin e tij, çdo gjë do të shkojë shumë mirë në hapat e mëpasme, në të kundërt, gjithçka do të shkojë keq.

Kur kam qenë në Ministrinë e Ekonomisë, në pozicionin e këshilltarit, kam propozuar ndryshime ligjore, të cilat për kohën u morën parasysh në një version tjetër. Kam pasur idenë time për të pasur një agjenci shtetërore, e cila do të ishte organi kompetent për të vlerësuar fizibilitetin e çdo projekti që paraqitej në çdo institucion shtetëror, pastaj të ndiqeshin

procedurat standarde për konkurrim. Kjo do të shmangte mungesën e profesionalizmit që kemi sot në administratë, sepse është një detyrë e vështirë, nuk është diçka që mund të ndërtohet menjëherë dhe do të bënte të mundur që një trupë e specializuar të jepte një pamje të qartë se ku do të shkojë ky koncension nesër.

Rrugët janë një nga elementet më thelbësore, më të vështira për t'u ndërtuar në variant koncensionar. Ka ndërthurje të disa metodave, të disa praktikave, për shembull, rruga e fundit Milot-Morinë. Faktikisht, i gjithë fizibiliteti, nga fillimi deri në fund, u bë me këshillimin total të IFC-së. Ne e morëm *en bloc* dhe e futëm në procedurë. Kjo është pjesa më e rëndësishme, ku unë mendoj se shteti do të përfitojë maksimalisht në financë, në efektivitet, në mirëpërdorim të parasë dhe, në përfundim, ajo që është më e rëndësishmja, përfitimi i produktit: rruga, ndërtimi, gjithçka.

Ervin Bushati – Nuk e di sa më kuptuat. Nuk e kisha për fizibilitetin. Bajpasi i Fierit është caktuar të ndërtohet, nuk është më studim fizibiliteti. Dakord, deri sa të arrijmë deri aty, këtë mund ta themi për të gjitha investimet që bëhen në Shqipëri, për rrugën Tiranë-Durrës... Çdo rrugë, patjetër që do një studim fizibiliteti. Nuk mendoj se çdo ministri mund të ketë arsye të prokurojë me patjetër pa bërë disa llogari dhe pa bërë një preventiv.

Problemi është mbasi lidhen kontratat. Çfarë ndodh me këto vepra publike, të cilat janë akset kryesore? Nuk po flas për koncesionet. Dakord. Kjo është një sfidë e re dhe do të vazhdojë të jetë gjithmonë.

Në momentin kur janë lidhur kontratat dhe është bërë tenderimi me fonde publike, kontrata nuk mbaron. Ku është problemi këtu? Autoriteti Rrugor thotë: "Nuk është problemi ynë, është problem financimi". Qeveritë fillojnë dhe e kalojnë topin në konspiracione politike: "E kishim prioritet, nuk e kishim prioritet", pastaj: "U penguan, nuk u penguan". Ndërkohë, nëse nuk janë ndarë fondet publike dhe niset një vepër publike, ajo do të priset rrugës, do të shkatërrohet.

Tani, nëse ne nuk e gjejmë me Autoritetin, nuk e gjejmë me qeverinë, nuk e gjejmë me partitë politike, mendoni se Komisioni për Prokurimin Publik, apo i gjithë sistemi i prokurimit, duhet të ketë disa përgjegjësi, i tenderon apo nuk i tenderon këto?

Ta zëmë se e ka kaluar fazën e fizibilitetit dhe bëhet kontrata, çfarë ndodh më vonë? Nuk ndiqet më nga ky komision apo nga komisionet përkatëse? Nuk duhet të kërkojë llogari askush?

Si mund të bllokohen këto fonde kështu? Duhet të hapen tendera pa qenë fondet? Këtë po them.

Ne kemi pasur rastin në vitin 2009 dhe kemi folur në këtë komision kur janë hapur një sërë tenderash. Tani, kuptohet, çdo parti do të fitojë pushtetin, por kjo nuk mund ta mbajë shtetin dhe qytetarët peng. Janë hapur tendera me 1 për qind të vlerës publike. Pastaj me 100 mijë lekë të rinj është hapur një tender me 10 milionë euro. Blihen dokumentet e tenderit dhe të gjithë e dimë si bëhet tenderi pastaj. Nuk ka më lekë, fillon fushata, vjen qeveria tjetër...

Erion Braçe – Zoti Bushati, pyetjen, ju lutem!

Ervin Bushati – Kjo ishte pyetja.

Erion Braçe – Kjo ishte pyetja?

Gjergji Kosta – Nëse të kuptova drejt, pjesa e parë e pyetjes ka të bëjë me këtë që thoni ju, por gabimet e kësaj transportohen te kjo pjesa e dytë, që po thoni ju. Gabimet e pjesës së parë përfshihen te kontrata. Fillon kontrata. Monitorimi është absolutisht më i keqi, më i dobëti që bëjnë organet shtetërore, duke filluar me mbikëqyrësin. Mbikëqyrësi i punimeve, që është individ i kryesor i licencuar, që mban përgjegjësinë ligjore për konfirmimin e investimit, është problemi më i madh në administratën shqiptare. Megjithatë ka përgjegjësi dhe pavarësi individuale, ai faturon dhe jep raporte fiktive në implementimin e këtyre kontratave, kurse pjesa e organit shtetëror, që duhet ta monitorojë këtë gjë, është pothuajse e padukshme.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Kosta, për prezantimin tuaj!

Jeni i lirë të largoheni.

Të paraqitet kandidati tjetër.

Mirëdita, zoti Kanina!

Ndodhemi këtu për shkak të ligjit “Për prokurimin publik” dhe të drejtës që buron nga ai ligj për të zhvilluar një seancë dëgjimore me secilin prej kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Ministrave për funksionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

CV-ja juaj lidhur me aktivitetin tuaj u është shpërndarë kolegëve deputetë, të cilët e kanë në tavolinë. Për një njohje më personale ne jemi të interesuar për të dëgjuar një ide tuajën lidhur me prokurimet publike në Shqipëri dhe, natyrisht, më specifikisht për punën dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, ku edhe ju keni shprehur dëshirën të jeni pjesë.

Keni fjalën 10 minuta për të bërë një prezantim tuajin dhe më pas kolegët deputetë në rast se do të kenë pyetje do t’ju adresojnë dhe ju jeni i lutur për të dhënë disa përgjigje,

Fjala për ju.

Nertil Kanina – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Unë quhem Nertil Kanina dhe konkurroj për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Ka rreth 9 vjet që aktiviteti im profesional është fokusuar kryesisht në fushën e prokurimeve publike. Kam mbajtur disa pozicione në disa institucione të ndryshme dhe aktualisht mbaj detyrën e përgjegjës të Prokurimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Për sa u përket tematikave dhe problematikave të prokurimeve publike në Shqipëri, pikëpamja ime është se ato burojnë kryesisht nga çështjet që janë të ndërruara me njëra-tjetrën, si dhe vendimeve që japin autoritetet kontraktore në lidhje me procedurat e caktuara të prokurimit publik dhe kanalizimi i tyre drejt Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë vendimmarrës në fushën e prokurimeve. Në gjykimin tim konstatoj se këtu ka një sërë çështjesh, të cilat duhet të rregullohen dhe të zgjidhen me mandatimin e trupës së re të këtij komisioni, si dhe me plotësimin e vendit të tij për çështje që lidhen me rritjen e besimit dhe besueshmërisë që duhet të ketë ky institucion. Ky komision duhet të japë vendime, të cilat, në gjykimin tim, duhet të jenë vendime me qëndrime të njëjta për çështje të njëjta. Në këndvështrimin tim, sot kjo është problematika më e madhe që lidhet me vendimmarrjen dhe veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik.

Nga eksperiencia ime kam konstatuar që vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik janë të ndryshme për çështje të njëjta si pikat e ujit. Tjetër gjë është edhe rritja e besimit të subjektet, të cilat janë pjesë e ankimimeve pranë këtij komisioni, gjithashtu edhe ruajtja e besimit të autoriteteve kontraktore. Në qoftë se duhet bërë më tepër në veprimtarinë e këtij komisioni, është rritja e besimit, e cila do të vijë përmes vendimeve që duhet të jenë të njëjta, siç i thashë më parë, dhe të mos ndryshojnë në çështje të ngjashme. Kjo gjë do të sjellë rritjen e besimit dhe do të ulë numrin e ankesave.

Sot numri i ankesave në Komisionin e Prokurimit Publik është shumë i lartë dhe kjo vjen për shkak të uljes së besimit, qoftë ndaj autoriteteve kontraktore, qoftë edhe ndaj Komisionit të Prokurimit Publik.

Unë mendoj dhe gjykoj se trupa e re, që do të jetë pjesë e Komisionit të Prokurimit Publik, duhet të rregullojë çështjen e vendimmarrjeve, të cilat duhet të jenë sa më të shpejta dhe në përputhje me afatet kohore që parashikon ligji “Për prokurimin publik”.

Ne, të cilët jemi pjesë e autoriteteve kontraktore, sot angazhohemi lidhur me sigurimin e nevojave dhe përmbushjen e misionit të autoriteteve kontraktore. Gjithashtu, konstatojmë vendime, të cilat kanalizohen drejt Komisionit të Prokurimit Publik dhe marrin një kohë shumë të gjatë deri te vendimmarrja përfundimtare, që mund të shkojë nga 1 deri në

2 muaj. Kjo është totalisht e papranueshme si ligjërisht, ashtu edhe për sa i përket pjesës së ngërçit që krijohet pranë autoriteteve për shkak të vonesave.

Kështu që këto janë problematika që lidhen me fushën e prokurimeve, të cilat duhen rregulluar. Personalisht ndihem i motivuar dhe i gatshëm të jap kontributin tim për të rregulluar të gjitha këto problematika me qëllim uljen e numrit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rritjen e besimit dhe nxjerrjen e vendimeve në një kohë sa më të shpejtë dhe të arsyeshme, brenda afateve ligjore që parashikon ligji.

Erion Braçe - Faleminderit!

Zonja Kushi, ka një pyetje.

Evis Kushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse ju keni një eksperiencë disavjeçare në fushën e prokurimeve publike, si e vlerësoni legjislacionin shqiptar për prokurimet publike? A ka problematika ky legjislacion? A ka nevojë për ndërhyrje, sepse disa nga këto problematika që ju renditët, në Komisionin e Prokurimeve Publike mund të vijnë edhe për shkak të hapësirave ligjore apo problematikave, pra çfarë mund të përmirësojmë në këtë legjislacion?

Faleminderit!

Nertil Kanina– Faleminderit!

Në këndvështrimin tim ligji i prokurimit publik është ndër ligjet ku të paktën në 10 vjetët e fundit është ndryshuar më shumë se çdo ligj tjetër. Gjithashtu rregullat e prokurimit publik ose udhëzimet, manualët e funksionimit dhe organizimit të prokurimit publik, kanë ndryshuar në mënyrë aq të shpejtë, sa ka një problematikë shumë të madhe në implementimin dhe zbatimin e tyre. Për shkak të punës që kam, kam konstatuar që shumë institucione ndeshin dhe hasin në problematikën e zbatimit të ligjit, për arsye se ligji është i arnuar. Në të mirën e prokurimeve publike do të ishte mirë që të kishim një ligj solid, pra një ligj standard dhe një VKM standarde pa shtesa dhe arna, me qëllim që të krijojë mundësi, për të gjithë funksionarët që angazhohen në prokurimet publike, ta kenë më të qartë ligjin dhe më të lehtë implementimin e zbatimit të tij. Arnimi i ligjit ka krijuar shumë problematika, të cilat shumë institucione nuk po mundën t'i implementojnë në punët e përditshme. Unë kam shumë kohë që punoj, por në dy tri vitet e fundit ndryshimi i ligjit ka qenë tepër dinamik dhe i pabesueshëm sesi ka ndryshuar kaq shumë, prandaj ka nxjerr@ dhe problematika.

Për sa i përket ligjit, në përgjithësi mund të them që është i mirë, por si çdo ligj tjetër ka edhe ky ka vakumet e veta, të cilat krijojnë problematika, duke filluar që nga autoritetet, te Komisioni i Prokurimit Publik apo edhe institucionet e tjera që kanë të bëjnë më zbatimin e këtij ligji. Gjatë punës ne kemi konstatuar që ligji ka vakume.

Erion Braçe – A ka ndonjë pyetje tjetër?

Fjalën e ka zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Duke parë CV-në tuaj, e shikoj që ke qenë në institucione të rëndësishme ku drejtues të saj sot janë të akuzuar lidhur me tendera dhe gjëra. Atëherë si jurist pranë sektorit të menaxhimit, që keni pasur detyrën në vitet 2015-2018, kur drejtuesi i institucionit akuzohet, personeli që bën menaxhimin përgatit dokumentet e tenderit dhe të gjitha gjërat, çfarë përgjegjësie ka, sepse titullari është ai që firmos, po pjesa tjetër dhe a është e nevojshëm që të hyhet në legjislacion?

Erion Braçe – Zoti Beqiraj, kam përshtypjen se ka një keqkuptim për shkak të CV-së, sepse bashkohet adresa e institucionit me datën, sepse zotëria nga janari i vitit 2018 dhe në vazhdim ka qenë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo është nga faqja tjetër, ky është gabimi apo jo?

Nertil Kanina – Nga janari i vitit 2015 deri në datën 8 janar 2018 kam punuar në Shtëpisë Botuese të Teksteve Mësimore, pranë Ministrisë së Arsimit.

Erion Braçe – Ka një keqkuptim, sepse datën e ka në fillim të përshkrimit ndërsa pozicionin e ka në fund.

Ismet Beqiraj – Pra, më shqetësoi fakti që futet drejtori i Përgjithshëm në burg, që është titullari në një institucion, dhe juristi, që ka përgatitur të gjitha procedurat e tenderit, jo. Pra kjo më shqetësoi.

Erion Braçe – Nuk ka qenë atje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo pra, në CV-i e keni gabim dhe këtë po jua shpjegoj. Në janar të vitit 2018 e në vazhdim e ka si jurist prokurimesh dhe në fund në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgut, nga viti 2015 dhe janar 2018 ka qenë jurist pranë sektorit të menaxhimit dhe në fund është Shtëpia Botuese e Teksteve Mësimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nertil Kanina – A mund të jap përgjigje për këtë?

Erion Braçe – Jo, sepse është e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është një çështje në gjykim dhe këto çështje nuk janë objekt yni.

Roland Xhelilaj – Një pyetje tjetër meqë u morëm me CV-në. Në vitet 2003 dhe 2008 ke punuar si teknolog ushqimor në Universitetin Bujqësor, në vitet 2003 dhe 2007 ke punuar si jurist në Universitetin e Tetovës, të dyja punët me kohë të plotë kanë qenë?

Nertil Kanina – Po të dyja njëkohësisht.

Erion Braçe – A ka ndonjë pyetje tjetër?

Deputete – Duke parë CV-në tuaj, mendoj dhe gjykoj që keni njohuritë e duhura për procedurat dhe ligjin e prokurimit publik, ajo që dua t’ju pyes është: a mendoni që ligji i Prokurimit Publik duhet të pësojë ndryshime?

Dhe e dyta, çfarë do të sillni ndryshe nëse ne si komision do të vendosim që ju të jeni anëtarë i KPP-së?

Faleminderit!

Nertil Kanina – Siç e thashë edhe pak më përpara ligji i prokurimit publik, në këndvështrimin tim duhet të ketë plotësime të vakumeve që ka, nuk besoj se fjala ndryshim mund të jetë ndonjë ndryshim rrënjësor.

Ndërsa për pyetjen e dytë...

Deputete – Pyetja e parë kishte të bënte edhe në faktin që nëse e gjykoni nga praktika dhe nga problematikat që keni konstatuar gjatë punës suaj...

Erion Braçe – Ju përgjigj një herë kësaj pyetjeje. Ju përgjigj edhe më herët dhe tha se ka nevojë për ndryshim dhe konsolidim të gjithë praktikës së ligjit.

Deputete – Dakord, por konkretisht mund të thotë...

Erion Braçe – Ju përgjigj një herë, çfarë kërkon për herë të dytë apo për herë të tretë. Urdhëroni!

Nertil Kanina – Për sa i përket pyetjes së dytë, nëse do të më besohet detyra e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik, nisur nga eksperiencia ime 9-vjeçare në prokurime publike dhe 6 vjet në institucione shtetërore, do të jepja kontributin tim për tri çështjet që përmenda më sipër: angazhimin tim për dhënien e vendimeve në një kohë të shpejtë dhe të arsyeshme, rritjen e besimit të këtij institucioni tek autoritetet kontraktore dhe subjektet, që janë pjesë e procedurave të ankimimit dhe vendimet, të cilat nuk do të ndryshojnë për çështje të njëjta. Në këndvështrimin tim, besoj se këto tri pika duhet të rregullohen urgjentisht brenda këtij komisioni.

Premtoj dhe jap garanci që do të bëj maksimumin për t’i rregulluar këto tri çështje nëse do të më besohet kjo detyrë.

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

Zoti Kanina, faleminderit, për prezencën, për prezantimin dhe për përgjigjet e pyetjeve të adresuara!

Jeni i lirë të largoheni!

Nertil Kanina – Faleminderit!

Erion Braçe – Të vijë kandidati tjetër.

Zoti Muçaj, mirëdita!

Hektor Muçaj – Mirëdita!

Erion Braçe - Jeni para komisionit për një seancë dëgjimore në funksion të ligjit, por edhe të propozimit të ardhur nga Këshilli i Ministrave për detyrën e anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik.

CV-ja juaj u është shpërndarë të gjithë kolegëve deputetë, të cilët e kanë para për njohjen personale ose profesionale të aktivitetit tuaj. Ne do të donim të dëgjonim një ide tuajën për prokurimet publike në Shqipëri dhe për më tepër, një ide tuajën për Komisionin e Prokurimit Publik dhe mënyrën e funksionimit të tij edhe në të ardhmen, përveç aktuales.

Fjalën e keni ju dhe më pas kolegët deputetë do të bëjnë pyetje, nëse kanë, dhe jeni i lutur të na jepni disa përgjigje.

Hektor Muçaj – Faleminderit!

Domethënë, nuk do të flas për pjesën e arsimimit dhe të përvojës, por do të hyj direkt te vizioni për KPP-në?

Vizioni im për Komisionin e Prokurimeve Publike, tashmë jo si pjesë e ekzekutivit, por si një organ i pavarur, është në frymën e propozimeve të shumta të organizmave monitorues, mbi të cilat u bënë edhe ndryshimet e domosdoshme ligjore për varësinë e institucionit, ku parimi më i rëndësishëm është ai i pavarësisë, tashmë i fituar me ligj, dhe parimi i barazisë, ku palët, autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, të jenë të barabartë në përballjen pranë institucionit.

Fjala “barazi” është e madhe, por detyra e çdo anëtari të këtij komisioni është që trajtimi të jetë i njëjtë para ligjit. Ky trajtim duhet të jetë konsistent dhe të shprehet në vendime. Vendimet e dhëna në zbatim të ligjit janë të tilla nëse jepen në kohën e parashikuar nga ligji. Respektimi i afateve të procedurave të ankimimit është po aq i rëndësishëm sa edhe vet thelbi i çështjes. E them këtë duke u nisur nga statistikat e 2 vjetëve të fundit, ku besoj se KPP-ja nuk krenohet me respektimin e këtyre afateve.

Qëndrueshmëria në vendimmarrje është një nga elementet kyçe që mendoj se Komisioni i Prokurimit Publik duhet ta kishte konsoliduar prej kohësh. Integriteti profesional dhe personal është një nga cilësitë e domosdoshme të çdo anëtari të ardhshëm, përfshirë

veten, nëse do të më jepet kjo mundësi, dhe ky integritet shprehet më së miri në vendimmarrje.

Aplikimin tim për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik nuk e kam bërë thjesht se kërkoj një vend pune, por sepse me përvojën e deritanishme mund të jap kontributin tim modest në përmirësimin e punës së këtij komisioni, si dhe problemet e përgjithshme që kanë procedurat prokuruese në vendin tonë.

Kaq mund të them për sa i përket komisionit.

Erion Braçe – Mos u kufizoni nga ajo që ju thashë në fillim!

Hektor Muçaj – Besoj se është e mjaftueshme.

Erion Braçe – Ka pyetje nga kolegët deputetë?

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Çfarë mendoni se nuk ka shkuar mirë me prokurimet publike në Shqipëri këto vite? Dëgjuam shumë përgjigje, si kuadri ligjor. Gjithmonë ka për të qenë sfida për ta ndryshuar kuadrin ligjor, por kjo nuk i ka penguar vendet e tjera të japin drejtësi ose të bëjnë procese të sakta. Ne nuk mund të rrimë vetëm te kuadri ligjor. Çfarë mendoni se ka munguar dhe mund të bëhet më mirë në vitet e ardhshme për të administruar fondet publike të qytetarëve?

Faleminderit!

Hektor Muçaj – Mendoj se kuadri ligjor është pothuajse i kompletuar në Prokurimet Publike të Përgjithshme në Republikën e Shqipërisë. Mbase mungesa e kontrollit rigoroz ose ritmik nga ana e KLSH-së do ta bënte shumë më funksional dhe më të administrueshëm nga pjesa e autoriteteve kontraktore miradministrimin e këtij fondi. Këtë e shikoj unë si sektor, kështu që nuk është se kam ndonjë vërejtje tjetër.

Erion Braçe – Po Kontrolli i Lartë i Shtetit sikur e ka kontrolluar disa herë Komisionin e Prokurimit Publik.

Hektor Muçaj – Po flisim për prokurimin publik në përgjithësi. Nëse flasim për Komisionin e Prokurimit Publik, në opinionin tim personal, KLSH-ja është në shkelje të kompetencave për të kontrolluar Komisionin e Prokurimit Publik. KLSH-ja, në bazë të ligjit, duhet të kontrollojë institucione që administrojnë fonde publike, ndërkohë që Komisioni i Prokurimeve Publike nuk administron fonde publike, pra mund të kontrollohet vetëm për administrimin e fondeve personale të saj. Kontrolli nga KLSH-ja i Komisionit të Prokurimeve Publike, si në kohën kur ishin anëtarët në emërim dhe tani, është në shkelje të kompetencave të KLSH-së dhe në shkelje të pavarësisë së këtij komisioni. Mund ta kontrollojë këtë komision për tenderët që kryen komisioni, pra blerje të vogla që janë vetëm

nën administrimin e komisionit, por jo në punën e tij. Është njëloj si të kontrollosh anëtarët e Gjykatës Kushtetuese në vendime për administrimin e fondeve publike, pra të kesh të drejtën të kontrollosh një institucion të pavarur në vendimet e tij vetëm për faktin se merret me miradministrim fondesh, kur, në fakt, fondet i administron pjesa që ka të bëjë me prokurimin jo me vendimet. KLSH-ja, në fakt, në rastin Komisionit të Prokurimeve Publike ka hyrë thellë te vendimet e këtij komisioni.

Ervin Bushati- Shikoj këtu që nga biznesi privat keni qenë një vit anëtar i Komisionit të Prokurimeve Publike në vitin 2013.

Hektor Muçaj – Jo nga biznesi privat, por nga Dhoma Tregtare.

Ervin Bushati- Konsulent biznesi, thotë këtu. Pse vetëm një vit? Nëse do të ktheheshit, çfarë risie do të sillnit, ose çfarë mangësish ka? Domethënë ne duam disa të vërteta që të marrim vesh çfarë ka ndodhur dhe çfarë mund të bëhet më mirë, prandaj e kthyem këtë proces për herë të dytë dhe u anuluan të gjitha kandidaturat herën e parë.

Hektor Muçaj– Nëse flasim për përmirësimin e punës, ai fillon nga pavarësia. Pra, fjala “i emëruar” sa do e mirë të jetë, është në një nivel më të ulët se i zgjedhur. Që në këtë moment, pra në momentin që zgjidhesh dhe jep llogari një herë në vit në parlament, standardet dhe cilësia e punës janë të ndryshme. Edhe presionet në parim ose në praktikë janë shumë më kollaj të përballueshme nëse je i zgjedhur dhe jo i emëruar. Përveç pavarësisë, të tjerat në lidhje me përmirësimin e punës i konsumuam.

Punuam aq pak, sepse në një formë a një tjetër kërkohej një rikonfigurim i ri i komisionit. E njëjta gjë ndodhi edhe pas dorëheqjes së 3 prej nesh, e njëjta gjë ndodhi edhe në komisionin e dytë pas nesh. Pra, qëndrueshmëria në vendimmarrje dhe serioziteti në punë lidhen edhe me garancinë që ke ti për ta bërë punën. Siç e thashë, pjesa që tashmë zgjidhesh dhe nuk emërohesh është shumë e rëndësishme në punën e këtij komisioni.

Xhevit Bushaj- Do të doja shkurt dy-tri gjëra pozitive pse ju kandidoni për anëtar të këtij komisioni, pra shkurt disa gjëra pozitive që shikoni ju te kandidimi juaj. Do të doja edhe diçka në lidhje me atë që nuk shkon te kandidimi juaj, pra çfarë të mete shikoni si kandidat?

Hektor Muçaj- Pjesa pse unë e ndjej veten mirë që kandidoj është sepse karriera ime është rritur shkallë-shkallë në 15 vjet. Edhe për arsimimin kam investuar shumë si nga ana personale, ashtu dhe financiare, kështu që rritja e karrierës ka ardhur natyrshëm.

Për sa i përket pyetjes nëse ka ndonjë gjë që nuk shkon, në fakt, për të qenë i sinqertë, nuk mund të bëj autogol këtu dhe të them se çfarë nuk shkon.

Xhevit Bushaj- Unë po ju pyes se çfarë shikoni si dobësi?

Hektor Muçaj- Si dobësi shikoj vendin e 16 të vënë nga komisioni *ad-hoc*, që më bën shumë përshtypje, si edhe skualifikimi herën e parë para 6 muajsh. Kjo në një formë a një tjetër në sytë e parlamentarëve shqiptarë në të gjitha versionet nuk është pozitive.

Erion Braçe- Në fakt, ky komision, sipas ligjit, nuk është i detyruar të respektojë radhën e vendosur nga propozimi që ka bërë Këshilli i Ministrave. Kështu që në këtë pjesë as mos u ndikoni hiç. Po të ishte kështu, herës që shkoi nuk do të kishte ndodhur një proces që rrëzoi të gjithë listën e ardhur nga Këshilli i Ministrave.

Erion Braçe- A ka pyetje tjetër?

Atëherë, zoti Muçaj, shumë faleminderit edhe për prezencën, edhe për prezantimin, edhe përgjigjet e pyetjeve.

Faleminderit, jeni i lirë dhe mund të largoheni!

Të vijë kandidati tjetër.

Zonja Ishka, mirëdita!

Ju jeni para këtij komisioni në përmbushje të ligjit për prokurimet publike dhe detyrimet që rrjedhin aty për deputetët e këtij komisioni për të organizuar një seancë dëgjimore me secilin kandidat, ardhur nga propozimi i Këshillit të Ministrave për funksionin e anëtarit të Komisionit të Prokurimeve Publike. Ne do të donim një prezantim tuajin. Prezantimin personal, jetëshkrimi u është shpërndarë kolegëve deputetë, të cilët e kanë të gjithë përpara, t'ju njohin qoftë me formimin tuaj, edhe me eksperiencat e punës që keni pasur më tutje. Na duhet një opinion juaji lidhur me prokurimet publike në Shqipëri dhe, natyrisht, edhe me një ide për funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik sot, apo në të ardhmen, në qoftë se do të jeni anëtare me të drejta të plota.

Fjala për ju për të bërë një prezantim, ndërkohë, kolegët deputetë janë të hapur për të bërë pyetjet.

Ela Ishka - Komisioni i Prokurimit Publik është institucioni më i lartë i prokurimeve, i cili shqyrton të gjitha ankesat që paraqiten nga operatorët. Është e rëndësishme, për mendimin tim, që komisioni të respektojë afatet kohore dhe ligjore 15 ditë për nxjerrjen e vendimeve.

Gjithashtu, është i rëndësishëm integriteti dhe paanshmëria e këtij komisioni.

Do të dëshiroja që komisioni të ishte 100% i pavarur duke pasur parasysh përzgjedhjen e kandidatëve nga Kuvendi, si dhe të ketë pavarësi ekonomike. Kjo do të sillte 100% paanshmërinë e komisionit në nxjerrjen e vendimeve.

Gjithashtu, do të ishte e rëndësishme të riformulohej pjesa ligjore e nenit për shqyrtimin e ankesave, që të ndryshohej afati. Kjo do të mund të përmirësohej në dy mënyra

në qoftë se do të shtohet stafi i inspektorëve dhe, siç e thashë, riformulimi i nenit për shqyrtimin e ankesave.

Respektimi i ligjit dhe marrja e vendimeve në një kohë sa më të shpejtë, do të ishte shumë e rëndësishme për procedurën e dhënies së vendimeve të shqyrtimit të ankesave, sepse kjo nuk do të shkaktohte probleme në mirëpërdorimin e fondeve publike, gjë e cila është shumë e dëmshme të digjen në fund të vitit.

Ky është mendimi im. Nuk di ç'të them tjetër!

Erion Braçe – Keni pyetje, kolegë deputetë?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Në të njëjtin pozicion keni qenë që prej vitit 2005 deri në vitin 2018?

Ela Ishka - Po! Kam qenë specialiste tek Transporti Ajror dhe më pas kam kaluar te Drejtoria Juridike, diku nga fundi i vitit 2006.

Ervin Bushati – Mban mend ndonjë emër të procesit të tenderimit në Ministrinë e Transportit, aktualisht edhe e Energjetikës?

Ela Ishka - Procese tenderimi, jo! Së fundi kam marrë pjesë në studimin e fizibilitetit të ndërtimit të aeroportit në Jug të vendit, si dhe në procedura të ndryshme prokurimi me vlerë të vogël.

Ervin Bushati – Kemi të bëjmë me investimet publike, por këto të infrastrukturës janë më të mëdhatë sidomos në Shqipëri perceptohen si më të mëdhatë.

Kemi pasur lejen e investimeve të mëdha publike, të cilat kanë mbetur në mes dhe ende vazhdojnë për 10 vjet, si për shembull bypas-i i Fierit apo Rrogozhinë-Plepa, vende të caktuara.

Pra, ku kanë qenë problemet kryesore? Pse shkojnë kaq gjatë këto investime publike, sipas jush, dhe çfarë do të bëni më mirë? Ne lidhim kontratat, të cilat i fiton më i miri, por në fund, qytetarët duan të dinë për efikasitetin e menaxhimit të fondeve publike. A lidhen me firmën më të ulët? Si zbatohet kontrata, se është fitimi i munguar, aksidentet etj.?

Ela Ishka - Mendoj se çdo gjë ka të bëjë me miradministrimin e fondeve. Në qoftë se ato do të jenë të miradministruara, apo do të shkonin aty ku duhet, çdo gjë do të ishte ndryshe. Kjo është e gjitha, nuk besoj të ketë gjë tjetër që nuk ka shkuar!

Ervin Bushati – Po flasim për një nga ministritë që merren deri 80 % të investimeve publike dhe vepra të rëndësishme, të cilat mbajnë peng ekonominë shqiptare. Në qoftë se do të kishit një rast të tillë, si do të vepronit nëse nesër do të jeni në këtë komision? Nuk është vetëm çështja e miradministrit të fondeve. Ka disa projekte, të cilat nisen dhe mbarohen,

por ka edhe disa projekte madhore, të cilat nuk mbarohen. Çfarë kemi bërë gabim? Na e thoni! Çfarë do të bëni ju nesër?

Ela Ishka - Për shembull, nga eksperiencia ime, pasi jam marrë shumë me rastet e shpronësimeve, ka të bëjë shumë edhe me ndryshimin e projekteve, sepse ministria ka qenë gjithmonë institucioni propozues. Të gjithë procedurën e ka bërë Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe çdo gjë ka të bëjë me faktin si ndryshon projekti, si shkojnë gjërat, pastaj ka të bëjë edhe me pronarët, se jo çdo gjë shkon drejtë, apo ashtu siç duhet. Si rrjedhojë, ka pengesa.

Ismet Beqiraj- Zonja Ishka, duke parë eksperiencën që keni në një pozicion në nivel të lartë në ministri, do të doja të të bëja një pyetje: nesër ju mund të jeni anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik, çfarë koncepti keni ju lidhur me një fenomen që ka ndodhur në Shqipëri, kur bëhen tenderimet dhe kompania fituese bën një zinxhir nënkontraktimesh, dora e parë, e dytë apo e pestë, si puna e bypass-it të Fierit etj. Sipas jush, duhet të vazhdojë kjo praktikë...

Ela Ishka – Cila duhet të vazhdojë? Nuk e kuptova! Më fal!

Ismet Beqiraj- Edhe një herë, çfarë koncepti keni lidhur me procedurat aktuale që bëhen për tenderimet, ku një kompani del fituese në prokurim dhe kjo pastaj ia shet punën, po jua them shqip, dorës së parë, të dytë, të tretë dhe të katërt. Është një praktikë që ndodh në Shqipëri me prokurimet.

Ela Ishka – Për mua është e rëndësishme respektimi i ligjit dhe trajtimi i barabartë i të gjithë operatorëve...

(Diskutime pa mikrofon)

Ismet Beqiraj – Ligji e ka, por unë nuk e kam të qartë, kështu që nesër ju duhet të jepni një mendim për rregullimin ligjor...

Ela Ishka - ... për rregullimin ligjor të...

Ismet Beqiraj – Rasti i *bypass*-it të Fierit, të cilin jemi duke diskutuar, e mori X, italian, grek apo gjerman, pavarësisht se çfarë mund të ketë qenë ai dhe e humbi, ai më pas ia dha X apo Y kompanie, e cila falimentoi, por ka edhe raste të tjera ku unë e marr dhe ia jap Xhevitit atje poshtë. Xheviti më pas ia jep një tjetri e kështu me radhë. A jeni ju dakord me këtë praktikë dhe keni ndjesinë si specialiste me eksperiencë që të bëni edhe propozime apo...?

Ela Ishka – Siç jua thashë çdo gjë bazohet në ligj dhe unë do ta respektoj ligjin dhe si të jetë e shkruar aty.

Erion Braçe – Deputeti po ju pyet nëse ju keni ndonjë ide se si zgjidhet historia e nënkontraktimit dorë pas dore dhe pas prokurimit i çon veprat në kalenda greke, siç është vepra konkrete që i rerefohet apo të tjera?

Kjo ishte pyetje që ju bëtë, apo jo?

Ela Ishka – Kam përshtypjen se kjo është një çështje më shumë politike sesa dhënia e mendimit tim.

Erion Braçe – Nuk ka gjë të keqe, pavarësisht se punoni në një ministri mund ta jepni mendimin tuaj. Unë besoj se në ministrinë ku ju punoni nuk funksionon që njëri flet dhe të gjithë mendojnë si ai.

A ka pyetje të tjera?

Shumë faleminderit zonja Ishka për prezencën dhe përgjigjet tuaja.

Ela Ishka – Faleminderit juve!

Erion Braçe – Zoti Dedndreaj, mirëdita!

Komisioni ynë është shumë i interesuar të dëgjojë nga ju një vizion tuajin lidhur me prokurimet publike, natyrisht edhe me rolin funksion dhe detyrat e Komisionit të Prokurimit Publik, për të cilin ju keni shprehur dëshirën të jeni anëtar dhe Këshilli i Ministrave ju ka propozuar pranë Kuvendit të Shqipërisë për një rol të tillë.

Natyrisht, CV-ja juaj për një njohje personale dhe profesionale me aktivitetin tuaj të deritanishëm u është shpërndarë kolegëve deputetë, prandaj do të ishim të interesuar për një ide tuajën për këtë institucion.

Fjala për ju.

Andi Dedndreaj – Faleminderit!

Ashtu siç jam shprehur edhe në kërkesën për aplikim, e kam bërë këtë për shkak të dy drejtimeve, angazhimit tim të prokurimit publike dhe periudha e gjatë që kam ushtruar këtë detyrë.

Këto të dy tipare kanë ndikuar që unë të konkurroj për komisionerin e Prokurimeve Publike, ashtu siç kam theksuar edhe në komisionin *ad hoc* të ngritur, një komision shumë profesional, ku zonja Erinda ishte kryetare e APP-së. Unë kam shprehur mendimin tim personal që me rregullimet ligjore që i janë bërë ligjit të prokurimeve publike të autoriteteve kontraktore nëpërmjet normimeve të saj dhe punës së mirë që po bëhet tashmë nga institucioni për përqendrimin e prokurimeve publike, si anëtar i komisionit të prokurimit, nëse ju pranoni të më zgjidhni, duke u nisur edhe nga eksperiencia ime, mendoj të kem dy drejtime të miat: respektimin e dispozitave ligjore për prokurimet publike për sa u përket

autoriteteve kontraktore dhe vlerësimin e ankesave dhe kërkesave në zbatim të neneve të ligjit të prokurimeve publike.

Unë si pjesë e komisionit të hartimit të dokumenteve standardeve kam qenë gjithmonë në anën e Komisioneve të Prokurimeve Publike, prandaj gjykoj dhe vlerësoj që me vendimet e Komisionit të Prokurimeve Publike deri në momentin që jemi duke folur për autoritetin kontraktor, Drejtoria Rajonale e Shkodrës ka qenë në anën e tyre, por nuk i kam pasur përballë asnjëherë gjatë gjithë kësaj veprimtarie.

Unë rishtazi e kam kërkuar këtë pozicion të komisionit publik dhe besoj se, nëse ju ma jepni shansin, do të fus po atë frymë që kam mbajtur për ato rreth 1000 procedura që kam bërë. Besoj se e kam marrë vlerësimin nga 11 drejtorë të Drejtorisë Rajonale të Shkodrës, të cilët më kanë dhënë vlerësimin dhe besimin e tyre për procedurat e prokurimit, por edhe me ndryshimin e 6 apo 7 drejtorëve administrativë, përsëri kam qenë i vlerësuar se këto procedura prokurimi qoftë për mirë, qoftë me të drejtë apo pa të drejtë, nuk janë bërë asnjëherë objekt i diskutimeve publike dhe aq më tepër i kam quajtur si satisfaksion të punës sime. Pra, edhe në rastet kur ministritë e linjës apo institucione të tjera kanë bërë kallëzime në organet ligjzbatuese, ato janë pushuar nga Prokuroria e rrethit Shkodër dhe unë këtë e quaj si pjesë të rëndësishme të punës sime.

Komisionet që ju përmenda pak më lart, si komisioni *ad hoc*, një komision shumë profesional, më ka vlerësuar me pikë, por mendoj të vlerësohet më shumë eksperiencia si pjesë e angazhimit dhe jo eksperiencia si numër pikësh, 5 vjet vjetërsi dhe 5 vjet...

Besoj se asnjë nga ju nuk e ka mandatin e radhës për shkak të vjetërsisë në punë, por si rezultat i punës suaj. Kaq kisha për sa i përket faktit pse kam konkurruar dhe ju mbetet ju të vlerësoni nëse jam i përshatëshëm.

Unë kam bërë një batutë të komisioni dhe kam thënë: “Jemi katër dhe keni për të zgjedhur 4 muskëtjerët e prokurimeve”. Kështu që jam i bindur për vlerësimin teknik që më ka bërë komisioni dhe, ju të nderuar deputetë, nuk keni besoj se jeni aq teknikë sa komisioni *ad hoc* për fushën e prokurimeve. Në qoftë se ka ndonjë hije dyshimi për vlerësimin tim, të merret puna ime në raport me vlerësimin. Duke qenë anëtar i njësisë së prokurimit apo shef prokurimi në autoritetet kontraktore, puna jonë, sidomos pas vitit 2008, është e dokumentar në sistem. Këtë e shoh të vlerësimi që ka dhënë komisioni. Nëse do të jem komisioner publik, është një punë të cilën e kam menduar, por nuk di të shprehem në detaje. Por shoh që ai jep vendime për dokumentet standarde dhe për vlerësimet.

Në fund, nëse do të isha komisioner nuk do të lejoja që vlerësimet e komisionit aktual të binin ndesh me vendimet e tjetrit. Kam pasur një procedurë roje. Komisioni e ka prishur

vendimin e procedurës me mendimin se është një çështje që do të zgjidhet pas lidhjes së kontratës dhe po për ankesën e personit **sheh** vendimin dhe vlerësimin **PVO-së**. Besoj se vendimet për këtë janë të pakta në Komisionin e Prokurimit Publik, nuk janë të shpeshta, sepse edhe ata janë zyrtarë të mirë të prokurimeve. Nuk do të jepja një vendim dy herë, pra herë vlerësim pozitiv, herë negativ. Autoriteti im kontraktor nuk ka qenë shumë pjesë e këtyre shqyrtimeve të Komisionit të Prokurimit.

Erion Braçe – Faleminderit!

A kanë pyetje kolegët deputetë?

Po, urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Arsyeja që ne e rihapëm garën është që të gjejmë njerëz që jo vetëm i njohin mirë procedurat, por edhe të kenë integritet, sepse ligjet dhe procedurat, sipas vendit dhe kuvendit, kanë qenë të sakta dhe nuk ka qenë ky problemi. Ashtu siç thatë edhe ju, shpeshherë jepen vendime të ndryshme që nuk janë të unifikuara dhe ky është problem. Për shembull, një vendim, të cilin hajde të gjejmë juridikisht, është privatizimi i dështuar i CEZ-it. Ju e keni parë edhe nga afër se si ka funksionuar dhe si ka dështuar. Në fillim e gjitha ishte ligjore, pastaj kthehet në një peng të madh për ekonominë dhe shoqërinë.

E para, se kanë ardhur këtu dhe e kanë shumë këtë gjë, pra pse 80% e këtyre tenderëve të rojeve shkojnë në përplasje? Masa e madhe e tenderëve që shkojnë te Komisioneri Publik kanë të bëjnë me rojet. I pyetëm edhe drejtueset, por unë nuk e kam marrë ende një përgjigje. Çfarë do të bënit ju që ta zhbllokoni atë dhe të kishit një eksperiencë për ta zhbllokuar? Në qoftë se ata merren vetëm me tenderë rojesh, mbeten të gjitha këta tenderët e mëdhenj të infrastrukturës, pra nëse na mbetet 10 vjet pa u bërë bajpasi i Fierit, nuk paskemi zgjidhur asgjë!

Andi Dedndreaj – Këtë çështje personalisht e kam trajtuar në komision dhe në tavolina. Për mua, tenderi i rojeve ka dy gjëra: ata vlerësojnë çmimin më të ulët dhe ofertën ekonomikisht më të nevojshme. Në qoftë se ne do ta vlerësonim ofertën ekonomikisht, pra do të vlerësonim kualifikimet, kapacitetet teknike të ofertuesve, unë besoj, dhe do t'ju jap çmimin, atë vlerë që ka 50%, që ky do të dilte si shkak procedural, sepse tenderët e rojeve kanë veçorinë e njohjes mirë të njëri-tjetrit dhe debatojnë për këtë gjë. Ndryshimet e ligjit e kanë normuar pagën, pra paga mesatare është bërë 360 mijë lekë të vjetër. Oferta ekonomike bëhet e qartë, pra të gjithë operatorët ekonomikë të rojeve hyjnë në ofertën ekonomike njësoj... Por, duke vlerësuar kapacitetet teknike, duke i dhënë 50% kapaciteteve teknike dhe 50% çmimit, besoj se do të vlerësohen kapacitetet teknike. Unë i kam parë kërkesat për

kualifikimin e rojeve. Edhe ju besoj se i keni parë. Po t'i shihni kërkesat e tyre për kualifikim, ata kanë futur aq shumë kërkesa, saqë e vlerësojnë teknikisht rojën. Unë e kam thënë që nuk ka pse u vendosni certifikata ISO, sepse rojat kanë certifikata sigurie, e cila është shumë herë më e rëndësishme se çdo certifikatë tjetër. Pra, kërkojnë aq shumë dokumente kualifikimi, ndërkohë që mjafton të bëjnë ndryshimin ligjor që të mos jetë vlerësim pas çmimit më të ulët, por sipas kapaciteteve teknik. Nëse bëhet kjo, mendojë se duhet të ecë. Ky është mendimi im personal, sepse nuk kam bërë pak tenderë rojesh, sepse kam bërë në autoritetin tim kontraktor dhe gjithandej. Kryeministri ka bërë një gjë të mirë për këtë gjë. Çfarë ka bërë Kryeministri?! Për mendimin tim, Kryeministri me mbështetjen tuaj sigurisht, se nuk i bën vetë gjërat ai, por ka bërë përqendrimin e prokurimeve publike. Kjo është gjëja më e mirë për mua, sepse na lehtëson. Nëse krijohet një institucion prokurimesh publike, është më e thjeshtë, sepse aty shkojnë specialistë të fushës. Nuk mundet elektrikë i Shkodrës të bëjnë tender ushqimesh. Nuk mundet Bashkia e Tiranës të bëjë një tender special për elektrikët, pavarësisht kapaciteteve që ka.

Kryeministri i ka përqendruar te Ministria e Brendshme. Lidhur me këtë kam kërkuar performancë. Them pse nuk e bën Ministria e Brendshme këtë? Ne të gjitha dokumentet i marrim te Ministria e Brendshme. Dashur pa dashur, ata i kanë rritur kapacitetin e rojës, pra nuk mund të krahasosh rojat e vitit 2002 me ata sot. Ata i kanë rritur kapacitetin e rojës, por duhen bërë në institucion.

Cila është kërkesa për kualifikim? Për kualifikimin me kapacitete teknike për pjesën e çmimit jepi 50% dhe duhet të funksionojë. Për mendimin tim, është mirë ta bëjë Ministria e Brendshme dhe zgjidhet. Pra, nuk ma lë mua në dorë si jurist që të vij unë të vendos për rojet e Dibrës apo as anëtarëve të komisionit që janë inxhinierë. Ligji e thotë: merr anëtarë të jashtëm. Po ku t'i marrësh anëtarët e jashtëm?! Duhet t'i marrësh në polici. Rojat janë shumë të bezdisshëm. 80% të ankesave janë vetëm rojash. Ata i dinë kapacitetet e njëri-tjetrit.

Për mendimin tim, KPP-ja ka edhe një problem, sepse në një vend thotë do t'i kërkojë vetëm në qytetin që ushtron aktivitetin. Në qoftë se them vetëm në Lezhë, unë e kam përjashtuar atë që e ka në Shëngjin. Domethënë ka edhe probleme teknike... Për shembull, kur thuhet vërtetim për roje nga policia, t'i nuk mund ta diskutosh vendimin e policisë, por komisioni thotë se vërtetimi i policisë nuk e ka të përcaktuar.

Për mendimin tim, përgjithësisht komisioni e lë pa veprim dispozitën 53/4, sepse komisioni sado i mirë... Unë jam shumë i gëzuar për funksionet që kam pasur aty, e kanë vlerësuar tjetrin, por 53/4 duhet të futet, pra është një devijim i vogël. Jo, thotë komisioni, ka

46, por e kanë vlerësuar 5 vetë që është devijim i vogël. Për shembull, roja e ka vërtetimin e policisë, kurse ti i thua se vërtetimi nuk është kategoria D dhe kategoria A.

Qëllimi im është, pavarësisht nëse jeni të opozitës apo të pozitës, prokurimet publike duhen të bëhen. Prokurimet publike, për mendimin tim, sigurohen nga dokumentet standarde. Dokumentet standarde krijojnë barazi në tenderë. Pra, edhe një herë, ndryshimet e fundit në Agjencinë e prokurimeve publike na kanë lehtësuar punën neve si njësi e hartimit të dokumenteve, sepse ajo është zemra e prokurimit.

Ervin Bushati – Zoti kryetar, a mund ta bëj një pyetje?

Keni eksperiencë të zgjatur në kohë dhe të përqendruar në këtë pikë, kam përshtypjen se jeni gjithmonë në Shkodër?

Andi Dedndreaj – Po, në Shkodër jam.

Ervin Bushati – Kuptohet se jeni marrë me një fushë në një zonë të caktuar, por këtu do të ketë shumë më presion. Çfarë mendimi keni, sepse këtu do të jetë shumë më e madhe edhe fusha, edhe presioni? Të lutem, shkurt dhe pa emocione!

Andi Dedndreaj - Kjo jetëgjatësi është ruajtja ime, sepse një mijë procedura nuk m'i kanë fituar një mijë firma. Në realitet punojnë firma serioze në Shqipëri. Këtë figurë unë e kam ruajtur me veprime korrekte me firmat dhe me autoritetet kontraktore. Pra, kjo ajo që më ka bërë mua dhe gjithsecili prej jush e beson. Kam ndërruar 11 drejtorë dhe përsëri ma kanë vlerësuar punën, pra kam ndërruar 100 e ca firma dhe përsëri e kanë vlerësuar punën. Pra, kam arritur, si shumë të tjerë, të krijoj figurën timen dhe e them me garanci të plotë se asnjë firmë nuk mundet me operatorët... Në komision presionin e bën operatori, se autoriteti kontraktor nuk e bën.

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga deputetët? Nuk ka.

Andi Dedndreaj – Faleminderit dhe më falni që u zgjata shumë!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Dedndreaj!

Të vijë kandidati tjetër.

Evis Kushi – Mirë se keni ardhur!

Ju jeni Blerim Braja?

Blerim Braja – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Kushi – Në zbatim të ligjit “Për prokurimin publik” jeni këtu për të bërë fillimisht prezantimin dhe më pas nëse kolegët do të kenë pyetje, do t’jua drejtojnë.

Blerim Braja – Faleminderit për vëmendjen!

Ju keni para CV time dhe shkurtimisht do të mundohem të zgjeroj pak atë që kam shkruar. Jam Blerim Braja, kam konkurruar për anëtar të KPP-së në pozicionin inxhinier ndërtimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, konkurroj për pozicionin inxhinier ndërtimi, kam një eksperiencë dhjetëvjeçare. Në vitin 2008 kam përfunduar studimet, dhe menjëherë jam punësuar pranë një zyre inxhinierike. Kryesisht, kam punuar në projektim dhe pak supervizion, sepse kanë qenë vitet e para, dhe pak te procedurat e tenderimit, sepse në atë kohë blerjet e vogla, një pjesë, bëhej me prokurim me elektronikë. Në vitin 2012 shkëputem nga sektori privat dhe ingranohem në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, sektor publik, pozicion të cilin e kam mbajtur deri në dhjetor të vitit 2017. Aty kam qenë i punësuar kryesisht në Drejtorinë Hidroenergjetike lidhur me monitorimin e kontratave koncesionare në fushën hidroenergjetike, ndërkohë që kam qenë edhe pjesë e grupeve të punës në Ministrinë e Energjisë lidhur me procedurat e dhënies me koncesion të hidrocentraleve.

Në vitin 2011 kam kryer një fakultet të dytë, për të zgjeruar pak fushën profesionale, në shkenca juridike, bachelor, për të ndërlidhur pjesën juridike të kontratave me pjesën teknike të pozicionit, pasi ndonjëherë ato krijojnë probleme, ndoshta për shkak të terminologjisë dhe se juristët nuk arrijnë ta konkretizojnë punën teknike.

Kandidimi im për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik lidhet kryesisht me dëshirën time për të qenë pjesë e një institucioni vendimmarrës, duke ndërthurur pjesën ligjore procedurale me pjesën teknike, që në volumn më të madh të procedurave publike janë punime civile, punime ndërtimi, të cilat mendoj se në vendimmarrjen e Komisionit do të ndikojnë pozitivisht duke pasur orientime, duke pasur diskutime gjatë vendimmarrjes, duke shkëmbyer vendime dhe për të rritur në njëfarë mase cilësinë e vendimmarrjes së këtij komisioni.

Në qoftë se unë do të zgjidhem anëtar i Komisionit të Prokurimeve Publike, do të preferoja ose do t'i parashtroja komisionit të shkurtohen afatet e trajtimit të procedurave. Një nga mënyrat që unë mendoj se kjo mund të arrihet është unifikimi i vendimeve të marra deri tani nga ky Komision, duke nxjerrë një udhëzim, një vendim apo duke ndërmarrë procedura ligjore që këto vendime të marra të jenë detyruese ndaj autoriteteve kontraktore. Për shembull, në rast ankimimi nga një operator ekonomik, ku ai mund të paraqesë një vendim të KPP-së, autoriteti kontraktor, në qoftë se sheh ngjashmëri të ankimimit me vendimmarrjen, ta marrë automatikisht për bazë, që të mos futen në procedura të tilla që të shkojnë në KPP, të

zgjatet vendimmarrja në dy-tre muaj, të ketë efekte financiare, por edhe kosto njerëzore, sepse të gjitha këto duan kapacitete njerëzore për t'i trajtuar.

Ky ishte pak a shumë prezantimi im. Jam i hapur për pyetje.

Erion Braçe – Faleminderit!

Kam unë një pyetje, zoti Braja.

Nga prilli i vitit 2012 deri në dhjetor 2017 thoni se keni punuar në AKBN. Çfarë keni mbuluar atje?

Blerim Braja – Kam punuar në të gjithë sektorët e Drejtorisë Hidroenergjetike dhe mund të përgjigjem pothuajse për pjesën e oponencës teknike, të trajtimit të projekteve teknike, për pjesën e monitorimit të kontratave, si dhe për HEC-et që janë vendosur në shfrytëzim. Gjithmonë ka problematika. Mund t'ju paraqes problematikat gjatë dhënies, gjatë trajtimit të kontratave dhe problematikat gjatë vënies në shfrytëzim, pasi unë nuk mendoj se problemet janë të zgjidhura, por se gjithmonë ka probleme. Prandaj janë njerëzit për të ndërhyrë, duke marrë iniciativë për ndryshime ligjore ose për t'i rregulluar këto anomali që mund të ketë një kontratë, një operator ekonomik.

Domethënë, jam i hapur për çdo lloj pyetjeje që lidhet me fushën e koncesioneve në hidroenergji.

Erion Braçe – Në rregull.

Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Desha të di, pse u larguat nga AKBN-ja në dhjetor të vitit 2017?

Blerim Braja – Për shkak të ristrukturimit. Nuk besoj se ka nevojë për më shumë koment.

Ervin Bushati – Edhe si inxhinier, edhe si projektues e shikoj se keni një CV të pasur edhe në projektim. Një nga problemet kryesore që kemi me prokurimet lidhet me prokurimet publike në infrastrukturë: vepra publike të cilat nisen dhe nuk mbarohen, dhe nuk është se vijnë për mungesë të projektimit, kapaciteteve projektuese apo edhe zbatuese, sepse në Shqipëri kemi parë të bëhen edhe projekte shumë të mira, edhe zbatime shumë të mira dhe në kohën e duhur. Ndërkohë, ka projekte, si bypass-i i Fierit apo të tilla në shumë akse rrugore, të cilat, për shkak të kontraktimit, unë aty e shoh problematikën, kanë mbetur varur ose janë zbatuar shumë keq.

Çfarë mendoni se mund të ishte bërë më mirë ose çfarë do të ndryshoni ju po të jeni nesër në këtë KPP-në e famshme?

Blerim Braja – Nuk besoj se pjesëmarrja ime në Komisionin e Prokurimit Publik do të ndikojë në mbarëvajtjen e një kontrate qoftë koncesionare, qoftë publike, por në gjykimin tim, si profesionist, pse ndodh ose ku qëndrojnë problematikat, do të preferoja të isha te pjesa e profesionit, sepse në KPP do të kemi një pozicion vendimmarrjeje, mund të gjykojmë për një produkt të një ankimimi, por në rastin konkret mendoj se të gjitha problematikat vijnë prej financimit. Një kantier i hapur, sa më shumë kohë zgjatet, aq më shumë problematika sjell. Nuk besoj se ngelet për çështje profesionale, nëse ka ose jo kapacitete, sigurisht që ka, sepse bota është e zhvilluar, është gjithnjë në zhvillim, ka zgjidhje.

Unë mendoj se zgjatja ose buxheti me buxhet afatmesëm në rastet konkrete ose në periudha të caktuara është problematikë në zgjatjen e afateve. Pastaj, ka efekt domino. Domethënë, në gjykimin tim, problematika vjen kryesisht prej financimit. Pastaj problemet teknike, përderisa janë teknike, zgjidhen. Sot është problem çështja e financimit dhe besoj se të gjitha produktet vijnë prej tij.

Është perceptimi im dhe ndoshta mund të mos jem i saktë.

Ervin Bushati – Kam edhe një pyetje të shkurtër, zoti kryetar.

Problemi i financimit themi ne, dakord, se unë jam financier dhe ti inxhinier, duket që po ta projektosh ti, unë duhet të ta jap. Ndërkohë, për shembull, rruga e Elbasanit, për problem projektimi mund të shkojë trefishi. Nuk janë vetëm probleme të financimit. Unë di që në inxhinieri vetëm një ... nuk bëhet. Lekët e qytetarëve nuk janë pa fund dhe ne e kemi këtë problem. Këtu patëm një kandidat, që vinte nga Autoriteti Rrugor, i cili tha që janë probleme të financimit. Jam dakord, por para se të tenderohen, duhet të jetë e qartë se cilave firma u jepen. Nëse një firmë italiane, e cila ka falimentuar në Itali, vjen këtu dhe fiton tenderin, nuk është më problem financimi, por kontraktimi. Për këtë e kisha fjalën. Po të kishim para pa fund, nuk do të na duheshin as projektuesit, as tenderuesit e asgjë tjetër.

Blerim Braja – Në këtë rast jeni shumë të saktë, kurse në rastin kur duhet të gjykojmë nëse këta operatorë i përmbushin kriteret, na garantojnë ne të kemi një produkt final brenda afateve dhe kostove që janë parashikuar ka lidhje me pozicionin e KPP-së.

Unë preferoj të jem pjesë e asaj me qëllim që bashkë me kolegë ekonomistë dhe juristë të kemi një vendimmarrje sa më të drejtë në bazë të dokumentacionit që na paraqitet.

Për sa i përket buxhetit, në qoftë se një objekt prokurohet për 24 muaj dhe buxheti është për 36 muaj, firma duhet t'i gjejë diku tjetër lekët me qëllim që 12 muajt e mosfinancimit t'i plotësojë me një kredi apo lekët e veta. Vonesa vjen për shkak të financimit.

Rasti juaj ishte shumë i saktë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo. Dua të jem pjesë e KPP-së për të gjykuar drejt në vendimmarrje, kuptohet brenda kuadrit të dokumentacioneve që paraqiten, sepse nuk mund të hamendësojmë.

Evis Kushi – Në CV-në tuaj duket qartë që arsimi juaj bazë është inxhinieria. Ndërkohë, keni deklaruar që keni bërë edhe fakultetin e shkencave juridike në Universitetin e Beratit, të cilin e keni filluar në shtator të vitit 2011 dhe e keni mbaruar në mars të vitit 2014. I bie ta keni mbaruar për 2 vjet e gjysmë. Nuk e kuptoj ...

Blerim Braja – Është lapsus. E kam mbaruar në korrik të vitit 2014. Janë studime 3-vjeçare Bachelor.

Evis Kushi – Keni bërë studime 3-vjeçare?

Blerim Braja – Po.

Evis Kushi – A mendoni që njohuritë tuaja juridike janë të mjaftueshme për të qenë anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik? A e njihni mirë këtë fushë?

Blerim Braja - Që në fillim unë e prezantova veten si inxhinier dhe thashë që kam zgjeruar njohuritë e mia në shkencat juridike me qëllim që një procedurë juridike ta përkthej në produkt teknik. Në eksperiencat e koncesioneve ka probleme ligjore, që në praktikë bien në kundërshtim.

Në qoftë se themi që kontrata e koncesionit hyn në fuqi me nënshkrimin e saj, atëherë vënia në punë e hidrocentralit apo e një objekti lidhet edhe me lejen e ndërtimit. Nga pikëpamja teknike këto koncepte juridike kanë disa probleme dhe në këtë kuadër unë kam zgjeruar njohuritë e mia.

Për aq sa më është dhënë mundësia gjatë eksperiencës sime, unë e njoh sistemin e prokurimit publik për shërbime konsulence, mbikëqyrje, projektim, zbatim, si dhe në fushën e koncesioneve gjatë pjesëmarrjes në komisionet e ngritura për dhënien me koncesion të hidrocentraleve. Komisioni ka një grup të gjerë profesionistësh ku secili mbulon profesionin e vet.

Erion Braçe – Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Unë kam tri pyetje.

Pyetja e parë ka të bëjë me eksperiencën tuaj 10-vjeçare në fushën e projektimit të procedurave të prokurimit publik dhe supervizimit.

Siç duket, ju keni qenë anëtar komisioni në lidhje me këto procedura, apo jo?

Blerim Braja - Gati në dhjetë procedura të tilla.

Ismet Beqiraj – Është bërë ndonjëherë ndonjëra prej tyre objekt i Kontrollit të Lartë të Shtetit për shkelje?

Blerim Braja – Janë rreth 25-30 procedura të tilla dhe pothuajse të gjitha janë trajtuar nga KLSH-ja. Ata kanë rekomandimet e tyre dhe çdo procedurë ka diskutime. Unë nuk pretendoj se jam më i miri, në situatën e dokumenteve, fakteve dhe njohurive që kam pasur në ato momente, jam munduar të kryej detyrën. Nuk kam pasur ndonjëherë masë disiplinore për detyrën që kam kryer. Ato janë kontrolluar nga KLSH-ja dhe nuk ka pasur ndonjë problematikë për t'u cilësuar.

Ismet Beqiraj - Për shkak të aftësisë suaj profesionale në fushën e projektimit, pyetja e dytë është specifike dhe lidhet me një zonë të caktuar. Besoj se keni qenë autor ose bashkautor i 38 projekteve.

Rikualifikimi i bulevardit kryesor të Ballshit është një projekt që nuk është kualifikuar në thithjen e investimeve. Ku qëndron problemi, meqë ju jeni marrë me këtë gjë? Përderisa nuk është kualifikuar në fondet rajonale të zhvillimit, ka të bëjë me cilësinë tuaj të projektimit?

Blerim Braja – Unë mund t'ju prezantoj vetëm atë pjesë që di. Unë jam projektuesi, kurse çështja e financimeve varet nga autoriteti.

Ismet Beqiraj – Si, si?

Blerim Braja – Unë jam projektuesi i projektit. Ai projekt është prezantuar para bashkisë dhe ata kanë bërë një prezantim para deputetëve të zonës që në vitin 2015. Ky projekt është hartuar me kërkesë të kryetarit të bashkisë.

Ismet Beqiraj – E di procedurën. Mos e komento atë!

Blerim Braja – Nuk ka lidhje. Thjesht, nuk ka pasur financime.

Ismet Beqiraj – Jo, nuk është ashtu.

Blerim Braja - Në qoftë se nuk e ka sjellë autoriteti kontraktor, nuk është përgjegjësi ...

Ismet Beqiraj - E mora përgjigjen. Të paktën, mësova se kush është projektuesi.

E treta, një nga problemet më të mëdha është në veprat, ku ju keni qenë mbikëqyrës, në 17 vepra shumë të rëndësishme anembanë Shqipërisë, të cilat nuk janë mbaruar dhe janë prishur. Në këto 17 vepra, ku ju keni qenë mbikëqyrës dhe kjo është një nga problemet më të mëdha sot, duke qenë edhe pjesë e asaj çfarë është bërë dhe çfarë po bëhet në Shqipëri, ju e keni kurajën civile nga pozicioni i anëtarit të KPP-së t'i denonconi këto shkelje.

Më konkretisht, do t'u pyesja lidhur me këto vepra: A kanë qenë objekt i KLSH-së veprat që janë jashtë standardit, si kanalizimet, rrugët, ndërtesat civile dhe kulturore, ujësjellësat?

Blerim Braja – Të gjitha këto objekte kanë qenë objekt i shqyrtimit nga KLSH, por nuk arrij ta gjej pjesën e standardizimit, ku qëndron ndarja, nëse janë jashtë apo brenda standardit. Ato vepra janë realizuar, janë funksionale dhe kanë qenë objekt i shqyrtimit nga KLSH.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Braja!

Po shoh nga CV-ja juaj, se në fund të vitit bëni 34 vjeç. A mendoni se keni arritur pjekurinë e nevojshme, personalitetin e nevojshëm për t'i rezistuar një presioni që mund të bëhet nga unë apo nga kryetari i këtij komisioni për një vendimmarrje të caktuar?

Blerim Braja – Unë mendoj se i përmbush kriteret për ta kryer këtë detyrë. Sigurisht, mendoj se i përmbush edhe kriteret fizike dhe psikologjike për të përballuar situata të caktuara. Puna ka gjithmonë problematika, të cilat zgjidhen një e nga një. Unë jam i gatshëm ta përballoj atë. Ne nuk mund t'i parashikojmë asnjëherë situatat që na vijnë në të ardhmen. Në fund të fundit, këto janë risqet që secili nga ne merr në punën e tij të përditshme. Unë mendoj se i plotësoj kriteret fizike dhe psikologjike për të përballuar pozicionin e anëtarit të KPP-së.

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Për kuriozitet, zoti Braja. Ju keni jetuar në Berat?

Blerim Braja – Jo, shkolla është në fundjavë, të shtunën dhe të dielën.

Erion Braçe – Dakord.

Faleminderit shumë, zoti Braja edhe për prezencën, edhe për prezantimin, edhe për përgjigjet e pyetjeve të deputetëve!

Jeni i lirë, mund të largoheni!

Blerim Braja – A mund të shtoj edhe diçka?

Në vlerësimin që është bërë nga komisioni, jam pyetur për pjesën juridike të kandidimit, ndërkohë që për pjesën teknike nuk jam pyetur. Për shkak të pyetësorit, jam dhe i fundit në listë. Më shumë për ta vënë në dukje, pastaj pjesa tjetër...

Erion Braçe – Nuk ka rëndësi fare. Sipas ligjit, ky komision nuk ka detyrim të respektojë renditjen që ka bërë KM.

Blerim Braja – Meqenëse procedura nuk lejon ankimimin, e gjej të nevojshme ta prezantoj, pastaj ...

Erion Braçe – Jo, ky komision është i lirë në gjykimin e tij dhe nuk merr fare në referencë, nuk e respekton renditjen që ka bërë KM. Kështu thotë ligji. Mos e kini fare merak!

Blerim Braja – Unë e ndjej për detyrë të prezantoj situatën, ku unë jam gjendur dhe më pas, do të vazhdoj normalisht.

Faleminderit shumë!

Gjithë të mirat!

Erion Braçe – Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu.

Besoj se do të mblidhemi edhe një herë, si komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta vendosim dhe ta shikojmë nga java tjetër. Mund të mblidhet grupi ynë. Mbani shënimet që keni bërë, sepse do t'ju duhen për të dhënë një gjykim mbi listën e kandidatëve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këta të tjerët nuk na begenisën, kështu që as ne nuk kemi ndonjë detyrim për t'i shqyrtuar ata që nuk na begenisin. Në raportin e komisionit për këtë çështje do t'u rekomandojmë të gjitha autoriteteve të shtetit, që sa herë t'u paraqiten këta kandidatë që nuk u paraqitën nëpër konkurse, të mos t'i marrin fare parasysh.

E thjeshtë fare, meqë nuk na begenisin, nuk i begenisim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si ishte ky që kishte bërë shkollë në fundjavë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mjafton ajo diplomë, që të ikin të gjithë tenderët për lesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky ishte një 99.

MBYLLET MBLEDHJA